



- Liderët e Kosovës takohen me negociatorë nga disa vende
- Krijimi i shërbimeve më të mira mjekësore
- “Koalicioni Kthimi” në udhëkryq

Editoriali

Hartimi i strategjive për negociata

Ky ishte një grup i posaçëm. Kohë më parë liderët kryesor politikë u takuan me negociatorët dhe vendim-marrësit kyç të vendeve nga mbarë bota për të diskutuar mbi aftësitë udhëheqëse dhe të negociimit gjatë fazave të tranzicionit në situata të ngjashme. Ambienti ku u zhvillua ky takim, në kështjellën Burg Shllaining në Austri, ishte mjaft piktoresk. Në këtë vend, prej datës 15 deri me 19 dhjetor 2003, u zhvillua një shkëmbim mjaft intesiv i përvojave në mes të zyrtarëve dhe negociatorëve të spikatur nga Irlanda Veriore, Republika e Irlandës, Izraeli, Palestina, Afrika Jugore dhe Kili. Konferenca mbi "Hartimin e Strategjive për Negociata" është sponsoruar bashkarisht nga Projekti për Drejtësi gjatë Periudhës së Tranzicionit i Universitetit të Harvardit dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe është mbështetur nga Insituti Kosovar për Hulumtime Politike dhe Zhvillimore (KIPRED) dhe Qendra Ndërkombëtare Ollof Pallme në Suedi. Njëherësh, kjo nisimë është përkrahur edhe nga shumë liderë ndërkombëtarë, përfshirë këtu ish presidentin e SHBA-ve, Bill Klintonin.

E një rëndësie të veçantë në këtë takim historik ishte edhe pjesëmarrja e pesë liderëve kryesorë kosovar: kryetarit Ibrahim Rugova; kryeministrit Bajram Rexhepi; kryetarit të Kuvendit Prof. Nexhat Daci; kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës Z. Hashim Thaçi; dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Z. Ramush Haradinaj. Ndërsa, nga njëra anë, përfaqësuesit e komuniteteve të turqëve, boshnjakëve dhe ashkalive morën pjesë në konferencë, nga ana tjetër, përfaqësuesit e serbëve i refuzuan ftesat dhe nuk morën pjesë në konferencë. Mbledhja u bashkë - kryesua nga ambasadori Volfgang Petriq, Përfaqësues i Përhershëm i Austrisë në Kombet e Bashkuara në Gjenevë dhe Tomas Hamarberg, sekretar i përgjithshëm i Qendrës Ndërkombëtare Ollof Pallme.

Në konferencë, folësit ndërkombëtarë në fillim dhanë një parashtrim të shkurtër të përvojave të tyre të mëparshme në negociatë, duke u ndalur me këtë rast në çështje të caktuara që janë me rëndësi të veçantë për Kosovën. Disa nga temat të posaçme që u trajtuan në këtë mbledhje ishin përgatitja për negociatë, ndërtimi i besimit me negociatorët brenda ekipit si dhe me ata nga pala kundërshtarë, udhëheqja efikase e bisedimeve shumëpartiake, krijimi i besimit në opinionin e gjerë dhe tek bashkësia ndërkombëtare, dhe përfshirja e akterëve të shoqërisë civile dhe minoriteteve në krijimin e një të ardhmeje stabile. Vlen të theksohet se kjo konferencë ishte një rast i volitshëm për drejtuesit e IPVQ-ve për të diskutuar mbi situatën në Kosovë si ndërmjet vete ashtu edhe me përfaqësues të shquar ndërkombëtarë.

Në këtë konferencë morrën pjesë Z. Xhon Bihël, Këshilltar në Qeverinë e Kosta Rikës gjatë marrëveshjeve për paqe në Amerikën Qendrore në vitin 1987 dhe ish sekretar gjeneral i Presidencës së Kilit; Z. Ebrahim Ismail Ebrahim, këshilltar politik i Zëvendëskryetarit të Afrikës Jugore dhe pjesëmarrës i lartë në Kongresin Nacional Afrikan në negociatat shumëpartiake në Afrikën Jugore; Z. Dejvid Ervin, negociator me përvojë në

bisedimet që sollën Marrëveshjen e së Premtes së Mirë dhe përfaqësuesi kryesor i Partisë Progressive Unioniste në Irlandën Veriore; Z. Pini Meidani, ish këshilltar për politikë të jashtme dhe negociator me përvojë i kryeministrit izraelit Ehud Barak në bisedimet e Kamp Dejvidit të vitit 2002; Z. Rolf Mejer, ish kryenegociatori i Qeverisë së De Klerkut dhe ish Ministër për Çështje Kushtetuese në Afrikën Jugore; dhe Z. Albert Rejnollds, ish kyremistër i Republikës së Irlandës dhe pjesëmarrës kryesor në procesin e paqes në Irlandën Veriore.

Në sesionin e fundit të konferencës, presidenti Ibrahim Rugova deklaroi se diskutimet kishin qenë mjaft cilësore dhe të dobishme dhe se ai konsideronte që takimi ishte jashtëzakonisht i suksesshëm. Ndërsa, Z. Hashim Thaçi shtoi se Kosova duhet ta fitojë besimin e bashkësisë ndërkombëtare kështu që shpresonte që kjo konferencë do të nxisë një përpjekje të re për kultivimin e marrëdhënive ndërkombëtare. Me t'u kthyer në Kosovë, Prof. Nexhat Daci, duke komentuar përshtypjet e tij nga seminari para mediave theksoi: "Pjesëmarrja në këtë seminar kishte rëndësi të dyfishtë për ne. Pikë së pari, ne mësuam nga përvojat e pjesëmarrësve nga vendet, të cilët tanimë i kanë tejkaluar këto probleme dhe i kanë ndërtuar shtetet e tyre, siç janë Afrika e Jugut, si dhe nga vendet tjera siç janë Irlanda, nga të cilët përvoja ne mund të mësojmë mjaft. Veç kësaj, ne ishim të izoluar prej problemeve tona të përditshme për tri ditë dhe së këndejmi, patëm një komunikim të shkëlqyeshëm ndërmjet veti." Ndërkaq, Dr. Fridhelm Frishenslager, ish kryesues i Departamentit për Demokratizim të OBES-së me këtë rast vuri në dukje se: "Bota është ballafaquar me këso probleme dhe ende përballet me to. Prandaj, pjesëmarrësit e kësaj konference që sollën përvojat e tyre të begatshme, kanë dëshmuar para liderëve politik kosovarë se duhet t'ia shtrëngojmë dorën sho-shoit sa herë që duhet gjetur zgjidhje për ndonjë problem."

*Frenklin De Vrieze dhe Besnik Tahiri,
Misioni i OSBE-së në Kosovë.*



Të mësojmë nga njëri tjetri

Çfarë kanë të përbashkët Afrika e Jugut, Irlanda Veriore, Lindja e Mesme dhe Kosova? Ku dallojnë ato? Një reagim i menjëhershëm mund të vë në pah dallimet gjeografike, historike dhe politike. Por pasi përsiasim, fillojnë të shfaqen gjërat e përbashkëta.

Wolfgang Petritsch,

Ambasador i Austrisë në Kombet e Bashkuara në Gjenevë dhe bashkë-drejtuës i simpoziumit "Zhillimi i Negociatave" në Austri



Wolfgang Petritsch

Çfarë kanë të përbashkët këto vende dhe rajone, është një histori e gjatë dhe e përgjakshme e luftës etnike, fetare, raciale për të emëruar vetëm ngjajshmëritë më të dukshme. Kjo është e vërtetë veçanërisht kur është fjala për fatin e njerëzve, i cili shpeshëherë karakterizohet me mungesë të tërësishme të drejtave themelore të njeriut, mjerim social dhe ekonomik dhe humbje të kulturës.

A kishte ide më të mirë se t'i bashkohesh përfaqësuesit e këtyre rajoneve të dëmtuara për t'i krahasuar botëkuptimet, për t'i dëgjuar ata të cilët kanë përjetuar situata të ngjashme ose madje ende janë në mes të një konflikti të thellë, si bie fjala izraelitët dhe palestinezët. Ose, për këtë çështje, të mësosh nga ata që me sukses kanë tejkaluar aparteidin, sikurse në rastin e Afrikës së Jugut ku të bardhët dhe të zezakët kanë fituar betejën kundër racizmit.

Pikërisht kjo ishte ideja pas takimit të kohës së fundit të cilin e bashkë-organizuan Univer-

siteti i Harvardit me "Projektin për drejtësi gjatë fazës së tranzicionit" dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë në Burg Shllajning, Austri. Kjo ngjarje tri ditore në mes të dhjetorit të vitit 2003, një pjesë e sponsoruar nga Qendra Ndërkombëtare e Olof Palmës Suedeze, i ka bashkuar përfaqësuesit e lartë të tri partive kryesore në Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse të Kosovës (IPVQ), me ish-negociatorët e paqës nga vendet e lartëpërmendura dhe rajonet, përfshirë Amerikën Qendrore. (Për fat të keq përfaqësuesit nga partitë minoritare kanë refuzuar ftesën për pjesëmarrje.)

"Zhvillimi i strategjive për negociatë" ishte tema e këtij takimi tepër interesant i cili më së shumti pati të bëjë me çështje teknike, p.sh., si bëhet përgatitja

për bisedime, si të ngriten aftësitë profesionale, si krijohen marrëdhëniet punuese, dhe si të punohet me partitë e llojllojshme dhe interesat në procesin negociues.

Por, përveç të mësuarit të aftësisë diplomatike dhe politike për ndërmjetësimin e marrëveshjes politike, unë personalisht isha i impresionuar me tregimet vërtetë të tmerrshme që treguan këta negociatorë të paqës nga e gjithë bota: aktivisti irlandez i cili kishte qenë i burgosur dhjetë vite, tani ia kishte kushtuar jetën e tij paqës dhe pajtimit; jug-afrikani i cili ka kaluar njëzet vite në burg, së bashku me Nelson Mandelën, dhe i cili kishte vendosur të arrijë deri te ish-shtypësit e tij me qëllim që në vendin e tij të fitojë vetëm paqë për të gjithë; homologu i tij i

bardhë, i cili si një zyrtar i regjimit aparteid kishte vendosur t'iu bashkohet forcave me shumicën e shtypur. Në këto ditë moderne, heronjtë i dhanë dëshmi bindëse autoritetit të drejtësisë dhe lirisë së njerëzore.

Mësimi përfundimtar - personal - prej këtyre takimeve në rrethana të zymta për Kështjellën "Burg Shllajning" është ky: "Sekreti i suksesit" për arritjen e qëllimit të dëshiruar të angazhimit të vërtetë në frymën e kompromisit demokratik duket sikur u shmangët kundërpasive të kaluara dhe qëndrimeve kryeneçe. Falë përpjekjeve të paepuara të të gjithë pjesëmarrësve, kjo konferencë vërtetoi se është një ngjarje premtuese që do të vazhdojë t'iu sjellë atyre dobi.



Së bashku në kështjellën e Burg Shllajning: Z. Ramush Haradinaj, Z. Nexhat Daci, Z. Ibrahim Rugova, Z. Hashim Thaci dhe Z. Bajram Rexhepi.

“Qytetarët e Kosovës meritojnë shërbime më të mira mjekësore”

Gjatë dy viteve të fundit Komisioni i Shëndetësisë i Kuvendit mori pjesë në hartimin e politikave mbi kujdesin shëndetësor dhe përcolli zbatimin e tyre. Në monitorimin e funksionimit të kujdesit shëndetësor në Kosovë, ky Komision merrë pjesë në përgatitjen e strategjisë për kujdes shëndetësor, përpunon programin e qeverisë për kujdes shëndetësor dhe i jep rekomandime Kuvendit. ASI zhvilloi një intervistë me Naim Jerliun, (nga LDK-ja), zëvendëskryesues i Komisionit të Kuvendit për Shëndetësi, duke filluar me rolin e këtij Komisioni në sferën e ligjvënies.

Intervistën e zhvilloi Dejvid Burstede, Zyra për Çështje Politike, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Z. Jerliu, sa ligje janë shqyrtuar nga Komisioni juaj? Sa janë aprovuar e sa janë shpallur nga PSSP-ja? Çfarë diskutohet në kanalet e Kuvendit përkitazi me legjislacionin e vitit 2004? Gjatë këtij viti, pritet të hartohen mbi njëqind projektligje të reja. Cilat nga këto ligje duhet të konsiderohen si prioritare?

Deri më tash Komisioni ynë ka shqyrtuar dhe aprovuar Projektligjin mbi inspeksionin sanitar dhe Projektligjin mbi produktet dhe pajisjet mjekësore, ndërsa Projektligji mbi kujdesin shëndetësor do t'i nënshtrohet shqyrtimit të dytë. Deri tani, vetëm Ligji mbi inspeksionin sanitar është shpallur nga PSSP-ja. Në listën e projektligjeve për këtë vit hyjnë disa ligje që ndërliken me shëndetësinë. Besoj se do të duhej t'i jepnim përparësi Projektligjit mbi ndërmarrjet private të kujdesit shëndetësor, Projektligjit mbi të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, Projektligjit mbi sigurimin shëndetësor dhe Projektligjit mbi institucionin e kujdesit publik shëndetësor në Kosovë.

Më 4 dhjetor 2003 Kuvendi ka miratuar Projektligjin mbi produktet dhe pajisjet mjekësore. Çfarë është qëllimi i këtij ligji?

Ligji mbi produktet dhe pajisjet mjekësore përcakton kornizën për aktivitetet që zhvillohen në sektorin e farmaceutikës si për furnizuesit, ashtu edhe për shfrytëzuesit e produkteve dhe pajisjeve mjekësore. Aprovimi i këtij ligji ishte me rëndësi, meqë Kosova ishte pjesa e vetme e

Evropës që nuk kishte ligj në këtë sferë.

Siç mund t'ju kujtohet, disa kritikë paraqitën amendamente për këtë projektligj gjatë rishqyrtimit të tij nga frika se projektligji mund të ndalonte importimin e produkteve të galeniumit nga shtetet e jashtme në Kosovë, e që tani nuk prodhohen në Kosovë. Pse këto amendamente nuk u morën parasysh para seancës plenare, për të cilën ishte caktuar shqyrtimi i dytë i projektligjit në fjalë?

Termi “Produkt i Galeniumit” ka të bëjë me produktet mjekësore që prodhohen në laboratorët e barnatoreve të galeniumit. Përderisa respektohen disa standarde dhe praktika më të mira, barnatoret kanë të drejtë t'i furnizojnë pacientët me këto produkte, pa ndonjë marketing paraprak apo autorizim nga fabrika prodhuese. Duke qenë i vendosur për t'i mbrojtur produktet e tilla vendore, Komisioni për Shëndetësi mbështeti pa rezervë propozimin e parë të këtij projektligji. Gjatë shqyrtimit të dytë në seancën plenare, u miratuan propozimet e deputetëve të Kuvendit, që nuk janë anëtarë të Komisionit për Shëndetësi, çfarë bie ndesh me Rregulloren e Punës. Është për të ardhur keq, por kjo nuk mund të ndryshohet.

Çfarë mund të na thoni në përgjithësi për Ligjin mbi kujdesin shëndetësor?

Projektligji mbi kujdesin shëndetësor, pas shqyrtimit të tij të parë në Kuvend, i është nënshtruar fazës së procesit le-



Naim Jerliu

gjislative në nivel të komisioneve. Duke pasur parashydh gjendjen shumë të pakënaqshme të kujdesit shëndetësor në Kosovë, krahasuar me vendet e tjera në Evropë dhe rajon, Komisioni ynë tani është duke u përgatitur për shqyrtimin e dytë dhe aprovimin e këtij projekligji sa më parë. Me këtë ligj, i cili është më se i nevojshëm për sektorin e shëndetësisë në Kosovë, ne synojmë krijimin e një sistemi efikas në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ky projektligj përcakton parimet themelore të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe financimit të tij, si dhe mbështetjen gjyqësore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshmërisë së këtij sistemi dhe mbizotërimin e ligjit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ky ligj parashikon që kujdesi shëndetësor në të gjitha nivelet të zhvillohet në mënyrë institucionale, ndërsa kjo do të sigurohet përmes organizimit të aktiviteteve në sektorin publik, privat, dhe në sektorët mikse. Përgjithësisht, mund të thuhet se ky projektligj, pasi të aprovohet, do të jetë një bazë e shëndoshë për ta vënë në binarë funksionimin e sektorit të kujdesit shëndetësor në Kosovë.

Si e vlerësoni seancën publike që u mbajt më 24 nëntor 2003?

Seanca publike për Projektligjin mbi kujdesin shëndetësor ishte seanca e parë që u udhëhoq nga Komisioni ynë dhe është i rëndësishëm sa aq edhe i dobishëm për punën që e pret Komisionin tonë në të ardhmen. Përveç sponsorit të këtij projektligji, edhe ekspertët dhe palët tjera të interesuara, patën rastin t'i transmetojnë opinionet e tyre. Përmes kësaj seance publike, Komisioni ynë mori informata shtesë, vërejtje, propozime dhe sugjerime që janë shqyrtuar me kujdes dhe tani janë përfshirë në projektligj si amendamente. Besoj se këto amendamente do ta bëjnë projektligjin më të efektshëm dhe do të shtojnë mundësitë për implementimin e tij.

Si do t'i përshkruanit marrëdhëniet tuaja me Ministrinë e Shëndetësisë? A do të mund ta merrni me mend vetveten duke hartuar legjislacionin tuaj? Cilët janë akterët kryesorë ndërkombëtarë me të cilët bashkëpunoni?

Me qëllim që t'i përmbushë si duhet funksionet e tij, Komisioni ynë bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë, e cila është e obliguar t'i ofrojë të dhënat dhe informatat që i kërkohen nga Komisioni ynë, përfshirë raportet e Ministrit të Shëndetësisë dhe të personave tjerë që autorizohen nga ai. Komisioni ynë që nga fillimi ka hartuar një plan për bashkëpunim efikas me Ministrinë e Shëndetësisë, por, siç e dini, kjo Ministri është ballafaquar me disa vështirësi në administrim dhe kjo në njëfarë mënyre ka pasur pasoja në bashkëpunimin tonë. Besoj se këtë vit bashkëpunimi me këtë ministri do të jetë më i mirë. Sa i përket bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, unë besoj se ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me institucionet me të cilët deri më tash kemi pasur bashkëpunim të frytshëm. Më kryesoret ndër to do të jenë Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Fondacioni Fridrih Ebert Stiftung (FEST.).

Shëndetësia është njëra nga sferat ku mbizotërojnë strukturat paralele. Çfarë mendojnë anëtarët serbë të Komisionit tuaj për këtë çështje?

Për fat të keq, strukturat paralele ende ekzistojnë. Kjo është e papranueshme dhe mbetet sfida, posaçërisht kur kemi parasysh përpjekjet e mëdha që i bën qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj për krijimin e një sistemi të unifikuar të kujdesit shëndetësor, që do t'u ofronte shërbime të barabarta të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike apo fetare. Përfaqësuesit serbë asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në punën e Komisionit tonë, meqenëse bashkëpunimi midis partive të ndryshme që

e përbëjnë këtë Komision dhe pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme që janë anëtarë të këtij Komisioni, ka qenë shumë i mirë. Siç e dini, kryesuesi i komisionit tonë i përket Grupit Parlamentar të Komuniteteve Tjera.

Çfarë janë sfidat kryesore për ofrimin e shërbimeve mjekësore në Kosovë?

Përmirësimi i gjendjes në sektorin e kujdesit shëndetësor paraqet njëherë nga sfidat kryesore të qeverisjes në Kosovë. Ne duhet t'i dyfishojmë përpjekjet tona për krijimin e një baze legjislative dhe vënien në jetë të projekteve që do të siguronin cilësi në kujdesin shëndetësor, në të cilin për momentin indikatorët e cilësisë së shërbimeve mjekësore janë mjaft të ultë. Unë mendoj se këtë vit është me rëndësi të aprovohet pakoja e ligjeve që kanë të bëjnë me shëndetësinë, të cilët i përmenda më herët. Gjithashtu, do të dëshiroja të shoh progres në projektet vitale të infrastrukturës shëndetësore: në onkologji, kardiokirurgji, kardiologji dhe në laboratorët për kontrollimin e cilësisë së barërave. Një nga elementet kyç është edhe përmirësimi i menaxhmentit të kujdesit shëndetësor, i cili duhet t'u përmbahet standardeve minimale që janë përcaktuar nga Ministria. Qytetarët e Kosovës meritojnë shërbime më të mira mjekësore.

A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim të organizuar nga OSBE-ja apo në ndonjë aktivitet mbështetës të ofruar nga kjo organizatë?

Disa anëtarë të Komisionit tonë kanë pasur rastin të marrin pjesë në trajnime të tilla. Kjo është shumë pozitive. Shpresoj se këtë vit Komisioni për Shëndetësi do të mund të mësojë jo vetëm nga shtetet në tranzicion, por edhe nga vendet me demokraci të zhvilluar, në mënyrë që të vihen bazat e bashkëpunimit në sferën e kujdesit shëndetësor.

Evropa e përjetuar individualisht

Dy deputetë të Kuvendit, Lulzim Zeneli dhe Nafije Gash, gjatë muajit dhjetor bënë një vizitë dyjavore në Skandinavi për të parë drejtpërsëdrejti punën e Parlamentit Evropian. Ata ishin ftuar nga Parlamenti i Suedisë tok me delegacionet nga Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia dhe Mali i Zi.

"Vizita në një vend me traditë të gjatë demokratike ishte shumë e dobishme, në kohën kur ne jemi duke kaluar për herë të parë nëpër procese demokratike," deklaroi Z. Zeneli.

Njëherësh, ai shfaqti mirënjohjen e tij të thellë si për rastin që iu dha për t'u takuar me delegacionet nga vendet tjera të Ballkanit ashtu edhe shansin për të shkëmbyer përvojat me ta. "Sfidat e Parlamentit tonë i gjasonin mjaft sfidave të parlamenteve të tjera të rajonit," theksoi ai.

Vizita e delegacionit nga Kosova u sponsorizua nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA). Drejtori i kësaj agjencie në Kosovë, Kristofer Sjöholm, ndoqi vizitën gjatë javës së parë, me ç'rast mbeti i impresionuar me ate që kishte parë.

Njëri nga debatet, të cilin deputetët e Kuvendit e Kosovës patën rastin të përcjellin ishte debati që u zhvillua në Parlamentin Suedez lidhur me ate se a duhet pranuar apo jo valutën e përbashkët evropiane.

Njëkohësisht, vazhdoi ai, diskutimet e fuqishme ndërmjet parlamentarëve të Suedisë ishin një befasi për ne. "Ishte një debat mjaft i ashpër. Na thoshte mendja se vetëm ne në Ballkan kemi debate të atilla."

Xhef Bjelli,

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i arteve skenike

Në kohën kur shumë njerëz pyesin veten se a mos vallë tanimë ka filluar fushata zgjedhore në Kosovë, disa deputetë të Kuvendit pohojnë se politika fare nuk u pengon atyre, për të bashkëpunuar me sho-shoin, përkundër përkatësisë partiake. Znj. Edi Shukriu nga LDK-ja dhe Z.Lirak Çelaj nga PDK-ja, anëtarë të Komisionit për Kulturë, Rini dhe Sport, janë dy deputetë të këtyllë. “Ne jemi të interesuar për krijimin e mekanizmave institucional që mbështesin mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës”, deklaroi Znj. Shukriu, kryesuesja e komisionit.

Intervistën e zhvilloi Xhef Billi, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Veç kësaj, që të dy janë duke bashkëpunuar që nga viti 2000, para se të zgjedheshin si deputetë në Kuvendin e Kosovës nga dy parti të ndryshme. Aso kohe, Znj. Shukriu ishte bashkëdrejtuese e Departamentit për Kulturë të UNMIK-ut, ndërsa Z. Çelaj ishte drejtor i Teatrit Kombëtar në Prishtinë. Përkundër presioneve politike qysh atëhere, që të dy mbetën të përkushtuar ndaj bashkëpunimit profesional në zhvillimin e kulturës në Kosovë.

Si ekspertë në fushat e tyre përkatëse, të dy deputetët e kanë marrë mjaft seriozisht detyrën e tyre për të mbikëqyrur Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. “Ne dëshirojmë që këto institucione të funksionojnë sa më mirë, edhe kur ekonomia është e dobët dhe kur kemi fare pak donacione për mbështetjen e aktiviteteve kulturore,” tha Znj. Shukriu. Megjithatë, ata tërhoqën vërejtjen se nuk ka qenë edhe aq e lehtë të kërkohet përgjegjësi nga Ministria për punën e saj.

“Ministrat kanë përgjegjësi ndaj liderëve partiak e jo ndaj Kuvendit,” vuri në dukje zotëri Çelaj, duke cituar marrëveshjen politike që bëri të mundur formimin e Qeverisë në vitin 2002.

Znj. Shukriu shprehu të njëjtin mendim dhe njëherësh u potoçoi se Ministria shpeshherë nuk u përgjigjet kërkesave për informim të komisionit. “I kemi



Në maj të vitit 2002 PSSP Michael Steiner e ktheu statujën e “Perëndeshës në fron” në Kosovë. “Perëndesha”, që besohet se është 6,000 vjet e vjetër, është figurinë terrakote që daton që nga koha e Neolitit dhe është zbuluar në një vend afër Prishtinës më 1956. Ajo i ishte marrë hua nga museu i Beogradit që nga marsi i vitit 1999, për një ekspozitë shetitëse.

dërguar shkresa Ministrisë për të kuptuar se si është shpenzuar buxheti dhe për çështje të tjera, por nuk kemi marrë përgjigje. Mendoj se Kryesia e Kuvendit duhet të angazhohet më shumë që Kuvendi dhe komisionet e tij t’i ushtrojnë ingerencat e tyre.”

Ministria ka marrë disa vendime të rëndësishme gjatë vitit 2003, përfshirë krijimin e Operës dhe Baletit të Kosovës. Megjithatë, komisioni i Kuvendit askurrë nuk është konsultuar lidhur me këtë çështje, pohuan Znj. Shukriu dhe Z. Çelaj, duke i befasuar

anëtarët e komisionit.

“Për krijimin e Operës dhe Baletit të Kosovës, anëtarët e komisionit u informuan nga lajmet në televizion,” vërejtë Znj. Shukriu. Me ta marrë lajmin komisioni reagoi, duke mbajtur kështu një seancë për të marrë

më tepër infomacione nga Ministria. "Drejtori i Operas nuk erdhi në seancë, por në vend të tij erdhi drejtori i Departamentit për Kulturë, i cili na dha një gjysëm-përgjigje, dhe nuk na dha asgjë me shkrim," vuri në dukje ajo.

Z. Çelaj shtoi se Ministria është dashur të bashkëpunonte me komisionin e Kuvendit, në mënyrë që të përfitonte nga idetë e anëtarëve të tij. "Ne donim të kishim një strategji afatgjatë për themelimin e Operas," tha ai. Meqë nuk ka mjaft këngëtarë profesionistë të operasë në Kosovë, vazhdoi ai, komisioni do të preferonte krijimin e një grupi instruktorësh për "krijimin e kuadrove të reja."

Pokështu, komisioni është duke kërkuar edhe më tepër transparencë nga Ministria lidhur me këtë çështje, përfshirë edhe mënyrën se si është zgjedhur drejtori i operas. Njëherësh, Znj. Shukriu bëri të ditur se komisionit i është thënë se "nuk nevojitej konkursi për zgjedhjen e drejtorit, ngase Opera ishte themeluar në kuadër të Filharmonisë," taktikë kjo, e cila sipas vërejtjes së saj u shfrytëzua për t'iu shmangur procedurave të duhura.

Kur nuk është në Kuvend, Znj. Shukriu kohën e saj ia kushton pasionit të saj që ka për arkeologjinë, lëndë të cilën e ligjëron në Universitetin e Prishtinës. Kohë më parë ajo qëndroi në Universitetin e Harvardit për studim shkencor. Zonja Shukriu shpreston se një ditë mbrojtja dhe gjurmimi i trashëgimisë kulturore do t'i sjellë beneficione afatgjata Kosovës. "Trashëgimia kulturore është një burim i begatë edhe për zhvillimin e turizmit dhe për investime në të ardhmen, por askush nuk e vret mendjen për këtë. "Në vend të një çasjeje serioze, shprehet ajo, "Ministri mori vendim për formimin e Institutit Arkeologjik, që në të vërtetë ishte



Edi Shukriu dhe Lirak Çelaj

një vendim politik, pa elaborat paraprak dhe pa u konsultuar fare me arkeologët."

Ajo në vazhdim theksoi se njëra ndër çështjet më të rëndësishme është kthimi i artifakteve, të cilat i ka rrëmbyer Beogradi. Pasuritë arkeologjike të Kosovës, ishin marrë hua për një ekspozitë, që u mbajt gjatë luftës në kryeqytetin e Sërbisë, por objekti i vetëm që u kthye ishte statuja e famshme, idoli i Prishtinës, theksoi Znj. Shukriu. Çfarë është edhe më keq, vazhdoi ajo e shqetësuar, "Gjysma e Muzeut të Kosovës me thesar etnologjik, është plaçkitur dhe bartur me kamiona ushtarakë gjatë luftës".

Përkundër faktit se është anëtare e komisionit për kulturë, Znj. Shukriu ka shpresë vetëm te UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare për kthimin e pasurisë së Kosovës nga Sërbia. "Ne duam që të gjejmë zgjidhje dhe mendojmë se duhet të vihen të gjithë mekanizmat, në rend të parë presionet dhe kushtëzimet e bashkësisë ndërkombëtare mbi Beogradin për këtë çështje," theksoi ajo.

Z. Çelaj ishte dakord me të, por shprehu shqetësimin se Kuvendi nuk mund të bëjë gjithaq për këtë çështje. "Për shkak të marrëdhënieve ekzistuese në mes të Beogradit dhe Kosovës unë nuk shoh mundësi tjetër pos miratimit të një rezolute. Ky është një problem politik."

Përpos obligimeve të tij në Kuvend, zotëri Çelaj është duke bërë përgatitjet për hapjen e teatrit të parë privat në Kosovë, i cili është duke u ndërtuar në kompleksin e Pallatit të Rinisë. Ai tha se do të donte që Kuvendi t'i përkrahte më tepër artet skenike. Ai poashtu vuri në dukje se nevojitej një ligj mbi kinematografinë, për t'i përkrahur më tepër kompanitë private për prodhimin e filmave dhe për të zëvendësuar rolin mbizotërues, që e ka pas dikur "Kosova Filmi".

Megjithatë, komisioni nuk ka staf ligjor apo ekspertë ligjor, të cilët do të mund t'u ndihmonin anëtarëve të komisionit për të marrë pjesë në hartimin dhe shqyrtimin e legjislacionit. Tri ligjet, ai për sportet, bibliotekat

dhe arkivat, që janë në kompetencë të komisionit u miratuan vjet, ndonëse, vuri në dukje Znj. Shukriu, duhen edhe shumë ligje të tjera, duke u nisur nga ai për trashëgiminë kulturore. Anëtarët e komisionit nuk kanë kushte për hartimin e ligjeve.

"Ne s'kemi as zyre. Thjeshtë jemi të shtrenguar që dokumentacionin e punës ta marim me vete në shtëpi," theksoi kryesuesja e komisionit. Z. Çelaj poashtu tha se është i zhgënjyer me mjetet që i janë vënë në dispozicion anëtarëve të komisionit. "Problemi kryesor është infras- truktura," shtoi ai.

Sidoqoftë, të dy anëtarët e komisionit janë më optimistë sa i takon tejkalimit të dallimeve ndëretnike dhe gjetjes së gjuhës së bashkëpunimit me minoritetet e Kosovës. "Ne nuk e shohim kulturën e Kosovës si të ndarë, ajo i takon të gjithë qytetarëve të Kosovës" potencoi Znj. Shukriu. "Kulturën e Kosovës e shohim si të përbashkët, si kulturë evropiane dhe si pjesë të një kulture globale.

“Koalicioni Kthimi” në udhëkryq

Krahasuar me periudhën e tensioneve të larta politike në fillim të vitit 2003, kur deputetët serbë të Kuvendit, të pakënaqur me vendimet e shumicës shqiptare, shpesh u rropatën për t'i bojkotuar seancat, madje duke u kërcënuar seriozisht se “do ta braktisin krejtësisht Kuvendin”, shumë analistë mendojnë se “Koalicioni Kthimi” është shndërruar në njërin nga grupet më aktive parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Ky ndryshim pozitiv çmohet si nga shumë përfaqësues ndërkombëtarë, ashtu edhe nga shqiptarët e Kosovës, ndërsa edhe udhëheqësia e këtij Koalicioni duket se është e kënaqur me këtë qasje të re.

Zoran Qulafiq,
Radio UNMIK-u, reporter televiziv dhe korrespondent i B-92.

Anëtari i Kryesisë së Kuvendit, Z. Oliver Ivanoviq shpjegon se “Kthimi” e ka kuptuar se vetëm pjesëmarrja e plotë dhe aktive në punën e Kuvendit, e jo bojkotimi i saj, është mënyra e vetme efektive për t'i mbrojtur interesat e serbëve në Kosovë. “Më parë ne reagonim në mënyrë emotive, të rrëmbyeshme dhe shpesh të paarsyeshme, kështu që shpesh ndodhi që madje të mos ia dilnim dot t'i parashtronim vërejtjet tona mbi disa projektligje brenda afateve të caktuara. Tani ne reagojmë më me arsye” - thekson Ivanoviq.

“Koalicioni Kthimi” është plotësisht i vendosur të jetë më aktiv në të ardhmen dhe t'i përdorë të gjitha mekanizmat parlamentare në dispozicion, përfshirë Kornizën Kushtetuese dhe Rezolutën 1244, për t'i mbrojtur interesat e serbëve,” - thotë Ivanoviq. “Vërejtja jonë kryesore është se shqiptarët e Kosovës ende po përpiqen shumë, madje haptazi, që t'i vënë serbët para një fait accompli dhe të krijojnë një bazë për Kosovën e pavarur, para se të zgjidhet çështja e statusit final. Në vend të kësaj, ne mendojmë se Kuvendi duhet të përqëndrohet ekskluzivisht në miratimin e ligjeve të duhura, që janë në favor të interesave të vërteta të të gjithëve që jetojnë në Kosovë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike” - vazhdoi ai.

“Përderisa ata këmbëngulin për pavarësi, ne do të insistojmë në kthimin e plotë të pushtetit të Beogradit këtu. Të dy këto opsione janë ekstreme, rrje-

dhimisht edhe shumë negative, dhe një klimë e tillë nuk po i kontribuon proceseve demokratike dhe zhvillimit të ekonomisë, që paraqesin nevojë vitale në Kosovë. Në vend që të merremi me çështje serioze të ekonomisë, ne e kemi bërë zakon ta keqpërdorim Kuvendin për promovim politik”, - pohon Ivanoviq.

“Si hap pozitiv, serbët e njohin institucionin e sapoformuar të Monitorit të Kuvendit të OSBE-së, edhe pse ata mendojnë

se do të ishte më efektive që ky institucion të parashohë sanksione të qarta për ata që i abuzojnë rregullat. “Në Ballkan” shton Z. Ivanoviq “njerëzit më mirë e kuptojnë gjuhën e sanksioneve”.

Krahas kësaj, serbët mendojnë se ekspertët legjislativë dhe ligjorë të bashkësisë ndërkombëtare duhet të kyçen më drejtpërdrejt në fazat e hershme të hartimit të projektligjeve, dhe kështu ta shtojnë efikasitetin e Kuvendit dhe ta parandalojnë miratimin

e ligjeve që nuk hartohen si duhet.

“Janë disa procedura në Kuvend, të cilat mund të përmirësohen, por çështja kryesore është të rikthehet besimi i ndërsjellë midis komuniteteve. Të gjithë në Kuvend duhet të kuptojmë se disa propozime, edhe nëse vijnë nga ana tjetër, mund të jenë të dobishme”, vëren Z. Ivanoviq.

Edhe Ilir Deda, këshilltar politik i Kryeministrit të Kosovës, është



Deputetët e KP-së dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit Oliver Ivanoviq dhe Gojko Saviq bashkë me udhëheqësin e grupit parlamentar të KP-së Dragisa Kërstoviq

dakord se "Kthimi" është duke marrë pjesë më aktivisht në punën e Kuvendit, dhe e çmon këtë ndryshim si hap shumë pozitiv, por gjithashtu pohon se shqiptarët ende i shohin përfaqësuesit serbë si dorë të zgjatur të autoriteteve të Beogradit. Qeveria e Kosovës shprehet se përfaqësuesit serbë do ta kuptojnë realitetin e ri dhe se do të fokusohen në përmirësimin e kushteve të jetesës së të gjithë qyterëve, posaçërisht të serbëve, në Kosovë.

Ndonëse "Kthimi" dorëzon amendamente për secilin ligj që i propozohet Kuvendit, përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës do të dëshironin që serbët të jenë më kooperativë dhe t'u kushtojnë më shumë vëmendje çështjeve të përditshme në Kosovë.

"Ne do të dëshironim që "Kthimi" t'i propozojë disa ligje. Ne do donim t'i shohim ata më të pavarur nga politika e Beogradit dhe të përqëndruar ndaj interesave të komunitetit të tyre në Kosovë. Unë i ftoj serbët të jenë më aktivë në punën e Kuvendit dhe së bashku ta ndërtojmë një të ardhme më të mirë në Kosovë", thotë Z. Deda.

Edhe pse ka pasur disa ndryshime që janë vlerësuar si hapa pozitivë, veprimtaria e tanishme e "Kthimit" nga shqiptarët e Kosovës shihet kryesisht si një përpjekje për ta ruajtur unitetin me sistemin ligjor të Serbisë, çfarë është e papranueshme për shumicën në Kosovë. Në anën tjetër, serbët nuk pranojnë çfarëdo lëshimi në drejtim të pavarësisë para se të zgjidhet statusi final i Kosovës.

Përfaqësuesit e Kthimit thonë se procedurat dhe mekanizmat e tanishme të Kuvendit kryesisht mjaftojnë, megjithëse ka vend për përmirësim. Një nga kërkesat kryesore që nuk është pranuar apo përbushur ende është krijimi i kushteve që do t'ua mundësonte deputetëve

serbë të Kuvendit të Kosovës të jenë të pranishëm në Prishtinë për ditë, pa ndonjë masë shtesë sigurie, si dhe nevoja e krijimit të një grupi të vogël të ekspertëve ligjorë që do t'u ndihmonin deputetëve të Kuvendit në përgatitjen e amendamenteve dhe këshillave të tjera ligjore para seancave të Kuvendit.

Por, "Kthimi" ballafaqohet edhe me telashe të brendshme. Nëse mbajmë mend mesazhet mjaft konfuze politike që u dërguan nga Beogradi në kohën e zgjedhjes së "Kthimit", mund të kuptohet fare lehtë se, siç kanë theksuar Z. Kërstović dhe Z. Ivanović, një numër i madh i anëtarëve të këtij grupi nuk ishin zgjedhur mirë. Kjo mund të përshkruhet si një mendim me të cilin pajtohen shumë përfaqësues politikë serbë në Kosovë. Për më tepër, formimi i një koalicioni të tillë heterogjen dhe joefikas ishte ndikuar kryesisht nga një politikë konfuze e disa liderëve të partive politike të Beogradit, që ishin thellë të përçarë me njëri tjetrin dhe që zhvillonin luftë të dyanshme për dominim politik. Si rezultat i rrethanave të tilla, shumë anëtarë të "Kthimit" thjesht nuk janë kompetentë, pa përmendur faktin se shumë nga ta nuk janë të motivuar të marrin pjesë aktivisht në veprimtarinë politike: "Për fat të keq, duhet të pranojmë se disa anëtarë të koalicionit nuk janë duke i kryer si duhet detyrat e tyre, disa nuk marrin pjesë aktivisht në punën e komisioneve, madje as nuk i përfundojnë seancat e Kuvendit. Duket se motivi i tyre i vetëm është që t'i marrin mëditjet e tyre" - deklaroi për ASI-n lideri i grupit parlamentar të "Kthimit" Dragisha Kërstović.

"Lirisht mund të them se, fatkeqësisht, vetëm rreth 8 anëtarë të "Kthimit", nga gjithsej 22, janë plotësisht dhe aktivisht të kyçur në veprimtarinë e tij, përdërisa të tjerëve nuk u interesojnë fare aktivitetet e Kuvendit.



Dragisa Kërstović gjatë takimit me PSSP Hari Holkerin.

dit. Shpesh ndodh që 8 deri 12 anëtarë të "Kthimit" të jenë fizikisht të pranishëm në seancat e Kuvendit, çfarë paraqet më pak se gjysmën e anëtarëve të Kthimit", ankohe Kërstović.

Por, nuk ekziston ndonjë mekanizëm efikas ligjor që do t'i parandalonte praktikatat e tilla të papranueshme, sepse vendimet kryesore mbi aktivitetet e Kthimit për momentin i janë rezervuar ekskluzivisht Kryesisë së "Kthimit", përbërë nga liderë të përçarë të partive politike në Beograd.

"Krahas gjithë këtyre trendeve negative, si dhe disa pengesave që shkaktohen nga shumica shqiptare, ne jemi plotësisht të vendosur ta vazhdojmë politikën e pjesëmarrjes aktive, duke i shfrytëzuar të gjitha procedurat dhe mekanizmat e Kuvendit për t'i mbrojtur interesat e serbëve në Kosovë. Korniza Kushtetuese dhe Rezoluta 1244, procedurat operative të Kuvendit dhe roli i PSSP-së, na ofrojnë mundësinë që t'i mbrojmë si duhet interesat tona. Praktikisht, nuk ka mundësi tani që Kuvendi të keqpërdoret", prononcohet për ASI-n Z. Kërstović.

Z. Kërstović tha se ai personalisht është shumë i kënaqur me punën e Monitorit të Ku-

vendit të OSBE-së, si dhe me rolin e PSSP-së, i cili "reagon mjaft ndershmë", edhe pse ende ekzistojnë disa vërejte të vogla. "Në tremujorin e fundit të vitit 2003, janë bërë disa shkelje të procedurave të Kuvendit dhe jam shumë i interesuar ta lexojë raportin e OSBE-së për këtë periudhë", tha Kërstović.

"Vërejtjet e mia kryesore janë se shumica e Kuvendit shpesh ka vënë në rend të ditës disa çështje që janë krejtësisht jashta kompetencave të Kuvendit. Procedura e përgatitjes së ligjeve duhet të jetë më serioze, dhe kjo mund të arrihet përmes pjesëmarrjes së ekspertëve ndërkombëtarë në fazat e hershme të hartimit të projektligjeve. Dhe, për fund, mendoj se do të ishte shumë konstruktive të krijohet një praktikë e kontakteve të rregullta midis përfaqësuesve të grupeve parlamentare, së bashku me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo do të na ndihmonte t'u shmangemi konflikteve dhe tensioneve të panevojshme në fazat e hershme të përgatitjes së projektligjeve. Ne të gjithë do të punonim shumë që ta krijojmë një klimë më të mirë besimi dhe mirëkuptimi, çfarë është në interes të qytetarëve të Kosovës", konkludoi Z. Kërstović.

Zhvillimet e fundit në Kuvend

Gjatë muajve të fundit Kuvendi i Kosovës zhvilloi debate intensive, mori vendime dhe iniciativa dhe miratoi ligje me rëndësi jetike për shoqërinë e Kosovës. Në vijim është dhënë një përmbledhje e përgjithshme mbi zhvillimet e fundit politike në Kuvend, nga mesi i muajit nëntor 2003 e deri në fund të janarit 2004

Franklin De Vrieze, OSCE Mission in Kosovo



Seanca e përbashkët publike për Ligjin kundër diskriminimit dhe Ligjin mbi barazinë gjinore

Seancat publike janë bërë praktikë e zakonshme

Komisionet e Kuvendit po i përdorin gjithënjë e më tepër seancat publike si mjete të rëndësishme jo vetëm për grumbullimin e informatave, por edhe për hartimin e ligjeve. Kështu, që nga nëntori i vitit 2003 janë organizuar disa ngjarje të tilla.

Më 24 nëntor 2003 Komisioni për shëndetësi mbajti një seancë publike për Projektligjin mbi prodhimet mjekësore, i cili më pas u miratua nga Kuvendi. Seanca e parë e përbashkët u mbajt më 9 dhjetor 2003, me ç'rast Komisioni për çështje juridike, legjislativ dhe kornizë kushtetuese dhe Komisioni për shërbime publike diskutuan së bashku mbi Ligjin kundër diskriminimit dhe Ligjin mbi barazinë gjinore. Në fillim të janarit të vitit 2004, u mbajtën dy konsultime publike brenda pesë ditëve. Njëri prej tyre u inicua nga Komisioni për kulturë, rini dhe sport, me qëllim të vlerësimit të nevojës për themelimin e Operas dhe Baletit të Kosovës dhe të pasojave të një vendimi të këtillë të ministrisë. Seanca publike që u mbajt më 13 janar 2004 nga Komisioni për financa dhe ekonomi për Projektligjin mbi odën ekonomike shënoi një debat tjetër të llojit të veçantë. Me këtë rast, përfaqësuesit e qarqeve të biznesit patën kënaqësinë që për herë të parë t'i bëjnë të njohura mendimet e tyre lidhur me një akt ligjor që drejtpërsëdrejti kishte të bënte me ta. Të dyja këto seanca kanë vënë në pah si nevojën për të marrë vendime në bazë të informacioneve gjithëpërfshirëse ashtu edhe për të filluar përfshirjen e palëve të interesuara që nga fazat e hershme të procesit të vendimmarrjes. Një debat tjetër i ngjashëm dhe mjaft i gjallë u organizua më 20 janar 2004 nga Komisioni për çështje juridike, legjislativ dhe kornizë kushtetuese për të diskutuar rreth ndryshimeve të propozuara për Kornizën Kushtetuese.

Mbështetja që ASI-it ka ofruar deri më tani për seancat publike, p.sh., përmes këshillave, mbështetjes konkrete dhe publikimit të Doracakut mbi seancat publike, mund të thuhet se ka qenë e

dobishme, ngaqë numri dhe cilësia e konsultimeve publike të organizara nga komisionet e Kuvendit jo vetëm ka ardhur duke u rritur, por edhe komisionet kanë filluar të iniciojnë edhe vetë mbajtjen e seancave publike.

Kuvendi shpalli të pavlefshme ligjet e Serbisë të miratuara pas 22 marsit 1989

Pas rekomandimeve të Komisionit për çështje juridike, legjislativ dhe kornizë kushtetuese, Kuvendi i Kosovës, më 11 dhjetor 2003, mori vendim t'i hedhë poshtë "të gjitha ligjet, aktet ligjore dhe nënligjore, vendimet dhe aktet e tjera të nxjerrura pas 22 marsit 1989 nga Serbia dhe Jugosllavia," (kur Kosova e humbi autonominë e vet në kuadër të ish-Jugosllavisë). Në vendimin e Kuvendit theksohej se që nga kjo datë e tutje çdo ligj i Serbisë që është miratuar në Kosovë "ishte zbatuar me dhunë, pra ishte në kundërshtim me vullnetin e shumicës së popullatës dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur dhe, si i tillë, është i papranueshëm." Po atë ditë, UNMIK-u lëshoi një deklaratë për shtyp në të cilën thuhej se vendimi i marrë nga Kuvendi "është jashtë kompetencave të Kuvendit të Kosovës dhe së këndejmi është i pavlefshëm dhe pa efekt." Ndërsa, Qeveria e Kosovës bëri të qartë se do ta respektojë vendimin e Kuvendit.

Komisioni për mjedis dhe planifikim hapësinor vizitoi Shkupin

Më 19 dhe 20 dhjetor 2003 një delagacion nga Komisioni për mjedis dhe planifikim hapësinor, i udhëhequr nga kryesuesi i këtij komisioni Z. Naim Maloku, vizitoi Parlamentin e Maqedonisë në Shkup. Me këtë rast, delegacioni nga Kosova u prit nga Z. Hysni Shaqiri, zëvendëskryesues i Parlamentit maqedon dhe parlamentari Z. Rafiz Haliti. Njëherësh, delegacioni u takua edhe me Z. Tome Trombev, kryesues i Komisionit për transport dhe ekologji, që merret me çështjet e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Të dyja këto komisione ishin dakord se bashkëpunimi është në interesin e tyre të ndërsjellë, meqë problemet e mjedisit shpesh janë probleme ndërkufitare. Diskutimet u fokusuan në pastrimin e lumit Vardar dhe ndotjen e ajrit që shkaktohet nga fabrika e çimentos afër kufirit me Maqedoninë. Veç kësaj, delegacioni pati edhe një takim të gjatë me ministrin e mjedisit Z. Dragoljub Matovski.



Naim Maloku

Kuvendi refuzoi mbajtjen e zgjedhjeve serbe në Kosovë

Në një seancë të jashtëzakonshme të mbajtur më 22 dhjetor 2003, Kuvendi i Kosovës miratoi një deklaratë me të cilën zgjedhjet e Parlamentit të Serbisë në territorin e Kosovës, të cak-tuara për 28 dhjetor 2003, u shpallën të "papunueshme dhe kundërkushtetuese." Së këndejmi, Kuvendi i Kosovës kërkoi nga UNMIK-u që ta parandalojë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, ngase ato paraqesin "përzierje flagrante në jetën dhe institucionet e Kosovës." Më tutje në këtë deklaratë u bëhej thirrje "të gjithë qytetarëve të etnitetit serb që të mos bien pre e manipulimeve negative që janë jo vetëm kundër interesave të Kosovës, por madje edhe kundër interesave të komunitetit serb në Kosovë."

Mirëpo, në një deklaratë të UNMIK-ut të lëshuar të njejtën ditë hidhet poshtë deklaratat e Kuvendit dhe njëherësh bëhet e ditur se "është një veprim i zakonshëm dhe i pranuar ndërkombëtarisht që votuesit të marrin pjesë në zgjedhje kur ata kanë të drejtë vote, pavarësisht se a banojnë apo jo në territorin që administrohet nga autoriteti i cili i organizon ato zgjedhje." Kështu që, deputetët e "Koalicionit Kthimi" fill pas përfshirjes së kësaj çështje në rend të ditës e braktisën seancën plenare.

Kuvendi aprovoi buxhetin e Kosovës për vitin 2004

Në po të njëjtën seancë të jashtëzakonshme, më 22 dhjetor 2003, Kuvendi i Kosovës aprovoi Buxhetin e Konsoliduar të Koso-vës (BKK-në) për vitin 2004. Kështu, BKK-ja ishte përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave konform Ligjit mbi menaxhimin e financave publike. Njëherësh, kjo çështje u diskutua edhe në Këshillin Ekonomik Fiskal, organi më i lartë këshilldhënës që përbëhet nga zyrtarë të lartë ndërkombëtarë dhe vendorë, përfshirë PSSP Harri Holkeri-n dhe kryeministrin Bajram Rexhepi. Më 31 dhjetor 2003, PSSP shpalli Rregulloren e UNMIK-ut mbi aprovimin e BKK-së për vitin 2004.

Vlen të theksohet se buxheti për vitin 2004 do të financohet tërësisht nga të ardhurat vetanake të Kosovës që pritet të arrijnë në 619 milion euro, me 13 milion euro shtesë nga suficitit i buxhetit të vitit 2003. Buxheti për vitin 2004 është 20% më i lartë se ai i vitit 2003. Vlerësimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave parashikojnë ngritje modeste të produktit të përgjithshëm vendor (PPV) në vitin 2004. Përderisa PPV në vitin 2003 ishte 1,2 miliardë euro, në vitin 2004 pritet të jetë 1,25 miliardë euro.

Kryetari i Kuvendit vlerësoi punën e bërë gjatë vitit 2003

Më 29 dhjetor 2003, Prof. Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, mbajti një konferencë për shtyp, për t'i informuar mediat vendore dhe ndërkombëtare lidhur me rezultatet e punës së Kuvendit gjatë vitit 2003. Me këtë rast ai bëri të njohur se, gjatë vitit 2003 janë mbajtur gjithsej 37 seanca plenare, për dallim nga viti 2002 kur ishin mbajtur 22 sosh, ndërsa Kryesia vitin e kaluar është takuar 38 herë. Gjatë vitit 2003 mesatarisht tri komisione të Kuvendit kanë mbajtur takime gjatë një dite pune, ndërsa numri i

përgjithshëm i takimeve të këtyre komisioneve ishte 565. Prandaj, ky aktivitet intenziv ligjvënës i Kuvendit rezultoi në 32 ligje të miratuara, 2 rezoluta dhe 3 deklaratat, plus 7 rekomandime dhe opinione të miratuara gjatë vitit 2003.

Veç kësaj, gjatë konferencës për shtyp, Prof. Daci dha edhe një parashikim lidhur me aktivitetet që pritet të zhvillohen gjatë vitit 2004. Me këtë rast, ai theksoi se ky do të jetë një vit i tensioneve të përgjithshme, jo vetëm për shkak të marrëdhënieve me fqinjët në veri dhe të gjendjes së banorëve në Kosovën veriore, por edhe për shkak të tensioneve pas rezultateve të zgjedhjeve si dhe konflikteve midis institucioneve vendore dhe UNMIK-ut.

Kuvendi u bëri nderim viktimave të Raçakut

Në fillim të sesionit plenar të datës 15 janar 2004, deputetët e Kuvendit të Kosovës u ngritën në këmbë për të mbajtur një minutë heshtje në shenjë nderimi për 45 shqiptarët e vrarë nga forcat serbe të sigurimit më 15 janar 1999, në fshatin Raçak. Këto vrasje ndikuan në përsheptimin e proceseve për thirrjen e konferencës së Rambujesë, pas së cilës më 24 mars 1999, filloi intervenimi i forcave të NATO-s. Deputetët serbë nuk morën pjesë në komemoracion.

Gjatë debatit të mëtejshëm mbi disa projektligje, kryesuesi i grupit parlamentar të LDK-së, Z. Sabri Hamiti, denoncoi atë që ai e quajti "mospërgjegjësi, mungesë disipline dhe destruktivitet të KP-së që orkestrohej nga Beogradi." Ndërsa, Z. Dragisa Krstovic, kryesues i grupit parlamentar të KP-së, reagoi duke theksuar se "ngjarjet e fundit në Kuvend nuk çojnë kah krijimi i një klime demokratike në Kosovë."

Rekomandimet e panelit lidhur me të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Në seancën plenare të mbajtur më 15 janar 2004 u shqyrtuan rekomandimet e Panelit special për Projektligjin mbi prokurimin publik. Ky panel, në përbërje të sponsorit të ligjit (qeverisë), palës kundërshtuese (Koalicioni Kthimi) dhe përfaqësuesit të palës së tretë (UNMIK-ut), kishte hartuar ca ndryshime që do të bënin të mundur një mbrojtje më të mirë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Grupi parlamentar i AAK-së kundërshtoi ndryshimet e propozuara nga ky panel dhe njëherësh kërkoi nga komisioni i Kuvendit për çështje juridike, legjislative dhe kornizë kushtetuese që t'i ndryshojë dispozitat e Kornizës Kushtetuese, ku përcaktohen procedura të posaçme për mbrojtjen e interesave vitale të të gjitha komuniteteve. Një anëtar i PDK-së theksoi se partia e tij pajtohej me disa rekomandime të Panelit, por jo me të gjitha. Prof. Daci reagoi duke theksuar se rekomandimet e panelit nuk mund të jenë të ndara. Prandaj, ai i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i mbështesin rekomandimet e panelit. Më pas, këto rekomandime u miratuan me shumicë votash.

Në seancën e mbajtur më 11 dhjetor 2003, Kuvendi nuk i aprovoi rekomandimet e Panelit special për Projektligjin mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë. KP dhe Komunitetet tjera votuan pro rekomandimeve që parashikonin pesë amendamente për masat operative që do të siguronin pjesëmarrje të barabartë në regjistrim për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të cilët i plotësojnë kushtet regjistrim.

Presidenti i Kosovës iu drejtua Kuvendit

Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova, për herë të parë që nga zgjedhja e tij në vitin 2002, më 22 janar 2004, iu drejtua Kuvendit, ashtu si është parashikuar me Kornizë Kushtetuese.

Në fjalimin e tij presidenti Rugova vlerësoi se gjatë katër vjetëve të fundit në Kosovë është arritur progres i madh. Ai në mënyrë të veçantë vlerësoi punën e Kuvendit të Kosovës, "i cili miratoi dhjetëra ligje sistematike, ligje të tjera dhe rezoluta e deklarata të ndryshme, në interes të popullit të vendit tonë." Sa i përket qeverisë, Dr. Rugova theksoi se "ajo funksionoi mirë" dhe "arriti të bëhet një autoritet stabil ekzekutiv."

Duke bërë fjalë për prioritetet në të ardhmen, Presidenti vuri në dukje se institucionet e Kosovës duhet të përqëndrohen më tepër në krijimin e një ekonomie stabile, në privatizim, në mbështetje të sektorit privat si dhe në gjetjen e zgjidhjeve për problemet me furnizimin me rrymë. Ai mbështeti bartjen e kompetencave nga misioni ndërkombëtar tek institucionet vendore. "Një ndër elementet më të rëndësishme është vlerësimi i strandardeve të përcaktuara, si të atyre që tanimë janë përmbushur, ashtu edhe të atyre që do përmbushen së bashku me UNMIK-un, OSBE-në dhe KFOR-in," - theksoi Presidenti Rugova.

PSSP lidhur me përfaqësimin e Komuniteteve Tjera në Kryesinë e Kuvendit

PSSP Harri Holkeri me anë të një letre e informoi kryetarin e Kuvendit, Nexhat Dacin, se kishte vendosur ta shpallë të pavlefshëm vendimin e Kuvendit të datës 22 janar 2004, mbi emërimin e përfaqësuesit të Komuniteteve Tjera në Kryesinë. Në këtë letër, PSSP-ja kërkoi që të rishqyrtohet çështja e zgjedhjes së përfaqësuesit të grupit parlamentar të Komuniteteve Tjera (KT) dhe të votohet në përputhje me Kornizën Kushtetuese (KK).

"Prandaj, Z. Daci është dashur ta udhëzojë Kuvendin që ta marrë parasysh dhe ta konfirmojë kandidatin me pëlqimin e deputetëve të KT-ve. Me udhëzimin e Z. Daci, Kuvendi nuk mori parasysh kandidaturën e Z. Xhezair Murati, për të cilin u pajtuan deputetët e KT-ve dhe, në vend të tij, votuan për Znj. Zehra Elezi, përfaqësuese e Vatan-it, e cila nuk mori pëlqimin e KT-ve. Për këtë arsye, veprimi i ndërmarrë nga Kuvendi paraqiste shkelje të qartë të nenit 9.1.7 (e) të Kornizës Kushtetuese, e cila parasheh se 'nga deputetët e Kuvendit [Kryesia] emërohet një anëtar i cili i përket asaj partie që është deklaruar si përfaqësuese e komunitetit joshqiptar dhe joserb të Kosovës. Metoda për emërimin e këtij anëtar i përcaktohet nga deputetët e Kuvendit, të cilët u përkasin këtyre komuniteteve," thuhet në letrën e PSSP-së.

PSSP kërkoi që kjo çështje të rishqyrtohet nga Kuvendi në përputhje të plotë me kërkesat e nenit përkatës të KK-së dhe dispozitave të Rregullores së Përkohshme të Punës së Kuvendit. Njëherësh, ai bëri të ditur se përfaqësuesit e KT-ve ia kanë shprehur shqetësimet e tyre të thella për shkak se, sipas tyre, një çështje e cila do të duhej zgjidhur nga vetë ata, ishte shqyrtuar në një seancë plenare të Kuvendit, në kundërshtim me qëndrimet e tyre të përbashkëta dhe pa i përfillur pikëpamjet e tyre.

Komisioni për personat e zhdukur priti një delegacion të të afërmëve serbë

Më 28 janar 2004, të afërmë të serbëve të zhdukur si gjatë dhe pas konfliktit u takuan me përfaqësues të Komisionit të Kuvendit për personat e zhdukur, që kryesohet nga Flora Brovina. Gjatë këtij takimi ku mbizotëroi një atmosferë e tendosur, përfaqësuesit e familjeve të serbëve të zhdukur kërkuan nga ky komision i Kuvendit që të angazhohen si në gjetjen e shqiptarëve etnikë, ashtu edhe të serbëve. Duke theksuar se komisioni i saj angazhohet për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës, Znj. Flora Brovina tha se kompetencat e komisionit të saj janë të kufizuara. "Ne mund t'ju ofrojmë ndihmë humanitare, të dëgjojmë çfarë keni për të thënë dhe të marim informata lidhur me mënyrën si janë zhdukur të afërmit tuaj, por mund të ofrojmë shumë pak ndihmë konkrete, ngase kompetencat për drejtësi dhe siguri janë në duart e misionit të OKB-së në Kosovë," - tha ajo.

U shqyrtuan dhe u miratuan ligje

Gjatë periudhës prej mesit të nëntorit 2003 deri në janari të vitit 2004, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi disa ligje. Ca ligje u miratuan pas shqyrtimit të dytë më datën e përcaktuar. Ligjet pa datë të përcaktuar vetëm janë përkrahur në shqyrtimin e parë, por - që nga fundi i janarit - janë ende duke u shqyrtuar nga komisionet e Kuvendit: Ligji mbi sportet (21.11.2003), Ligji mbi kadastrën (04.12.2003), Ligji mbi transportin rrugor (15.01.2004), Projekligji mbi barazinë gjinore, Projekligji kundër diskriminimit, Projekligji mbi shëndetin, Projekligji mbi bashkëpunimin me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi (TNKJ), Projekligji mbi Odën Ekonomike, Projekligji mbi tregtinë me naftë dhe produkte të naftës në Kosovë, Projekligji mbi kinematografinë.



Pamje nga salla e renovuar e Kuvendit

Kushtet e punës dhe pronësia pasqyrojnë pavarësinë e Kuvendit

Në kuadrin e programit mbështetës 18 mujor ofruar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER), jam ftuar si ekspert, që në emër të Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës, që të përkujdesem për procedurat e prokurimit, vënjen e rrjetit dhe përtritjen e zyrave. Për këtë qëllim, kah fundi i nëntorit të vitit 2003, u formuan dy grupe. Nga fundi i shkurtit të vitit 2004, ata do ta bëjnë një vlerësim të hollësishëm të nevojave.

Piter Vanhojte,
Ish-anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës dhe ekspert kyç në programin e AER-it për mbështetje Kuvendit të Kosovës.

Vlerësimi i parë, që u bë tetorin e kaluar, dëshmoi se së pari duhet të zgjidhen disa probleme. Para se të fillonim me instalimin e pajisjeve të reja, kulmi që pikonte dhe sistemi i vjetruar e i stërngarkuar i furnizimit me rrymë, kanë qenë problemet kryesore, me të cilat u desh të përballëshim. Për shkak të konstateve të vazhdueshme lidhur me pronësinë e ndërtesës së Kuvendit, për fat të keq, nuk ishte lehtë që të zgjidheshin këto probleme. Edhe pse zyrtarët e Kuvendit thonë se ndërtesa i takon Kuvendit, në disa pjesë të tij, p.sh. në dhomën e serverit, stafi i Kuvendit nuk ka qasje. Si rrjedhojë, stafi i Kuvendit nuk mund t'i zgjidh madje as problemet më të thjeshta, p.sh. ndonjë rënie të serverit, sepse kjo është kompetencë e Ministrisë së Shërbimeve Publike. E njëjta situatë duket se është edhe me rrjetin telefonik. Ky rrjet në fillim është instaluar nga UNMIK-u, por në të vërtetë, është shfrytëzuar bashkarisht nga UNMIK-u, Kuvendi dhe PTK-ja. Një zgjidhje do të mund të gjindej nëse arrihet ndonjë marrëveshje midis Kuvendit dhe partnerëve tjerë, në të cilën do të përshkruheshin në hollësi përgjegjësitë e secilës palë. Ne nuk konsiderojmë se gjendja e tanishme paraqet zgjidhjen më fatlume.

Ne jemi të bindur se, siç ndodh në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore, Parla-

menti duhet të jetë i aftë që të veprojë i lirë nga çdo presion i jashtëm, në çfarëdo rrethane. Për këtë arsye, Kushtetuta e Belgjikës parasheh ndarje strikte midis Legjislativit (Parlamentit), Ekzekutivit (Qeverisë) dhe Gjyqësisë. Kjo ia ofron Parlamentit mundësinë që, si organ më i lartë shtetëror, të ushtrojë kontroll mbi qeverinë në mënyrë krejtësisht të pavarur. Pavarësia e Parlamentit të Belgjikës është gjithmonë e garantuar; ky Parlament vendos vet mbi buxhetin e vet, infrastrukturën e vet dhe mbi çkado që ka të bëjë me të. Fakti se Kuvendi i Kosovës nuk mund ta mirëmbajë tërë ndërtesën dhe rrjetin e vet, por varet shumë nga palët e treta, siç është Ministria e Shërbimeve Publike, rezulton në një varësi nga organet 'më të ulëta', të cilat Kuvendi do të duhej t'i mbikëqyrte. Ndaj, pavarësia e Kuvendit duhet të sigurohet patjetër.

Sidoqoftë, nuk mjafton që të pajtohemi vetëm me parimin e pavarësisë - kjo duhet të shihet edhe nga qytetarët. Prandaj, është absolutisht e domosdoshme që të gjitha shërbimet që i përkasin qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare e që s'kanë të bëjnë me Kuvendin, të largohen nga ndërtesa e Kuvendit sa më parë që të jetë e mundur. Si simbol fizik i demokracisë, ndërtesa e Kuvendit duhet t'i përkas Kuvendit, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Kjo është arsyeja kryesore pse ne fuqimisht i mbështesim planet e Ministrisë së Shërbimeve Publike për t'i zhvendosur të gjitha shërbimet që nuk i përkasin Kuvendit

në objekte të tjera. Nëse bashkësia ndërkombëtare nuk vendos ta financojë ndërtimin e zyrave të reja të qeverisë në ndonjë vend tjetër, për shkak të mungesës së hapësirës për zyrë në Prishtinë, do të kalojnë disa vjet para se ky proces të përfundojë me sukses.

Më në fund, ne shpresojmë se kjo iniciativë të rezultojë me sigurimin e hapësirës më të madhe për zyra për stafin e Kuvendit, çfarë do të ndikojë që edhe Kuvendi të mund të angazhojë më shumë njerëz për t'u ndihmuar deputetëve në kryerjen e detyrave të tyre. Në këtë mënyrë do të bëhej e mundur që edhe deputetëve t'u sigurohen zyrat e tyre personale. Kjo ofron disa përparësi; kjo do t'i inkurajonte deputetët e Kuvendit që të qëndrojnë edhe më tutje në Prishtinë, edhe nëse parashihet të mbahen vetëm një numër i vogël i mbledhjeve të komisioneve apo nëse me rend të ditës parashihet vetëm ndonjë seancë e shkurtë plenare, sepse ata nuk do ta konsideronin më këtë humbje kohe. Kjo gjithashtu do ta shtonte bashkëpunimin midis deputetëve dhe kuadrove tjera në Kuvend. Nëse ndonjë deputet është duke punuar në ndonjë projekt propozim për ndonjë ligj, ai apo ajo, do të mund të kontaktonte më lehtë me ekspertët në Kuvend, për t'i qartësuar dhe tejkaluar vështësitë që mund të paraqiten. Përparësia më e madhe, megjithatë, do të ishte fakti se me sigurimin e zyrave për deputetë, ne do të mund të krijojmë një mjedis pune dhe veprimtarije ku



Peter Vanhojte

deputetët nga grupe dhe parti të ndryshme, do të mund të takoheshin joformalisht dhe të diskutonin mbi projektligjet dhe propozimet e ndryshme, para se të votonin për to. Si në të gjitha parlamentet tjera, këto kontakte dhe diskutime joformale formojnë bazën për një institucion të mirëfilltë demokratik, sepse ofrojnë mundësinë e përgatitjes së vendimeve, larg çfarëdo presioni dhe pa iu ekspozuar syrit kritik të mediave.

Posedimi i zyrave personale në një ndërtesë të njëjtë është gjithashtu pjesë e procesit të ndërtimit të ekipeve. Fundja, deputetët para së gjithash do të jenë kolegë, edhe nëse kanë mendime të ndryshme apo nëse u përkasin partive të ndryshme. Bashkëpunimi i afërt në fund do ta mundësojë krijimin e një qëndrimi për respekt të ndërsjellë, çfarë do të rezultojë në një Kuvend më efikas dhe më të autoritativ.

Furnizimi me energji elektrike - Kosova ka nevojë për pronësi politike

Vizita zyrtare e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Vienë në dhjetorin e shkuar pati një veçori kryesore: më 12 dhjetor u zhvillua një diskutim intenziv mbi nevojën e krijimit të një politikë të sukseshme për energjinë në një shoqëri në tranzicion, siç është Kosova, dhe mundësitë e Kuvendit të Kosovës për krijimin e një politikë të tillë. Kjo vizitë u organizua nga fondacioni Fridrih Nauman Shtiftung, si pjesë e programit për këmbime rajonale për Kosovën dhe u përgatit në bashkëpunim me Departamentin e Demokratizimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Dr. Volker Kier, Ekspert i politikave të energjisë dhe ish-anëtar i Parlamentit të Austrisë

Delegacioni nga Kosova, që përbëhej nga anëtarë të Komisionit për Ekonomi dhe Financa, atij për Tregti dhe Industri si dhe Komisionit për Buxhet, më parë kishte vizituar Selinë e OSBE-së dhe Parlamentin e Austrisë, për t'u takuar me përfaqësues të lartë të këtyre institucioneve dhe për të këmbyer ide dhe informata. Diskutimi mbi energjinë ishte pika e fundit që ishte papaparë me programin e vizitës, por mund të thuhet se takimet e mëparshme kishin krijuar një bazë optimale për "një tryezë të rrumbullakët mbi energjinë". Pothuaj të gjitha çështjet që i shtruan deputetët e Kuvendit të Kosovës preknin elemente thelbësore që kishin të bëjnë me nevojën për rikonstruktimin e mirëfilltë të industrisë së energjisë elektrike dhe për prodhimin e mjaftueshëm dhe profitabil të energjisë elektrike në Kosovë në planin afatgjatë.

Duke diskutuar për çështjet kyçe që kishin të bëjnë me krijimin e një politikë efektive mbi energjinë që do bazohet në parimet demokratike, ne shpejt arritëm në çështjen qenësore: Si të organizohej KEK-u dhe si të bëhej "ndarja e pushtetit" duke marrë parasysh rrethanat specifike politike dhe ekonomike në Kosovë. Me fjalë të tjera: si do të mund të zgjidhej e ashtuquajtura çështje e pronësisë?

Për të gjetur zgjidhje shpresëdhënëse për këtë çështje qenësore, duhet mbajtur mend se

procesi i tanishëm i vendim-marrjes është në duar të akterëve të pabarabartë: në njërin anë janë organizatat ndërkombëtare, ndërsa në anën tjetër Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, që përfaqësojnë popullin e Kosovës. Padyshim se, për të krijuar një sistem të ri të përgjegjësive, duhet të ridefinohen si roli i "ndërkombëtarëve", ashtu edhe ai i "vënderëve". Pas konstituimit të Kuvendit (që është krijuar si rezultat i zgjedhjeve të lira dhe demokratike) dhe formimit të Qeverisë, është e domosdoshme që pushteti për t'u marrë me çështjet e energjisë të bartet tek Qeveria e Kosovës - natyrisht nën kontrollin e Kuvendit. Në këtë mënyrë de facto do t'i jepej fund edhe statusit të padefinuar të KEK-ut.

Duhet të kihet parasysh se tani në Kosovë nuk ekzistojnë rrethana normale të tregut dhe se prandaj situata në Kosovë nuk mund të krahasohet me një ekonomi të hapur. Në këtë rrethana, është e pamundur që të gjindet ndonjë investues që do të investonte në industrinë e energjisë elektrike në Kosovë. Por, nevojiten "investues" të tillë që do ta financonin ripërtitjen dhe modernizimin e tërë sektorit të energjisë në Kosovë. Në këtë aspekt, posa-çerisht nëse merren parasysh faktet gjithëpërfshirëse të mbarështruara mjaft mirë në një fletë të bardhë ku flitet për strategjinë dhe



politikën e energjisë elektrike në Kosovë (Shtylla e BE-së, IPVQ-të - Zyra për Energji), hapat e ardhshëm duhet të jenë të qartë: bashkësia ndërkombëtare duhet ta marrë rolin e investuesit dhe të shfrytëzojë mundësitë që ofrohen nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) apo nga burimet e ngjashme për financim.

Në këtë mënyrë, do të mundësohej krijimi i një strukture të ekuilibruar të interesave dhe ndikimit të përbashkët të të dyja palëve: duke e vënë pronësinë

politike në duar të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-ve), ndërsa përgjegjësitë që kanë të bëjnë me çështjet e financimit apo investimit në duar të "ndërkombëtarëve" - përfshirë mbikëqyrjen. Për ta zhvilluar ekspertizën dhe menaxhmentin e përgjegjshëm në këtë situatë jashtëzakonisht të vështirë sociale, ekonomike e rrjedhimisht, edhe politike,

vetëm një lloj i tillë i "ndarjes së pushtetit", do të mund t'i krijonte parakushtet e nevojshme që tregu i energjisë elektrike në të ardhmen të jetë efikas dhe i hapur. Privatizimi i sektorit të energjisë mund të ndodhë vetëm nëse përmbushen këto synime.

Për një zhvillim më të shpejtë, bashkëpunimi i ngushtë midis IPVQ-ve dhe ekspertëve të paruar ndërkombëtarë është jetik. Unë mendoj se kjo detyrë e veçantë do të bie mbi supet e Bashkësisë Evropiane.

Kuvendi përgatitë tri ligje për energjinë

Pas shumë analizave të detajuara dhe miratimit të rekomandimeve nga Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur me 19 qershor 2003 (shih buletinin informativ të ASI-it nr. 8), Komisioni për Tregti dhe Industri filloi hartimin e tri ligjeve për energjinë. Nisma e Komisionit u ndihmua dhe u përkrah edhe nga ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Bajrush Xhemaili, Kryesues i Komisionit për Tregti dhe Industri.

Pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për të rregulluar çështjen problematike të fushës së energjisë në Kosovë, nga ana e disa pjesëmarrësve në këtë sektor, nga ana e Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Tregti dhe Industri u ngarkua që të hetojë shkaqet e gjendjes së rëndë në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).

Pas hetimeve të bëra dhe në bazë të fakteve të mbledhura, Komisioni përgatiti një raport, për të cilin ishte parashikur të mbahej një debat në njërin nga seancat e Parlamentit. Komisioni kreu këtë punë. Kështu, ne vizituam KEK-un me ç'rast bëmë inspektimin e stabilimenteve dhe njëherësh diskutuam me stafin e kësaj kompanie si rreth problemeve me të cilat ballafaqohen KEK-u, ashtu për probleme të tjera të kësaj industrie. Me ta përfunduar inspektimin, hartuam raportin. Në konkluzionin e raportit, ne dhamë edhe ca udhëzime, në bazë të të cilave pas një debati në seancën parlamentare, u nxorën këto rekomandime:

1. Të formohet komisioni parlamentar për energjetikë;
2. Të nxirren ligjet për veprimtarinë e KEK-ut: Ligji për Energjetikë, Ligji për Minierat, Ligji për Kërkime Gjeologjike dhe Ligji për Organin e Rregullatorit;
3. Qeveria e Kosovës të marrë sa më shpejt përgjegjësitë në fushën e energjetikës dhe të formohet Ministria për Energjetikë;
4. Të rishqyrtohet ristrukturimi i KEK-ut në mënyrë që të bëhet

profitabil dhe konkurent në tregun rajonal të energjisë derisa të nxirren ligjet përkatese sistemore;

5. Të anëtarësohet KEK-u si entitet i veçantë në institucionet e Sistemit Elektroenergjetik të Evropës Juglindore ;
6. Të përkrahet strategjia e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike;
7. Të ndërtohet linja ndërlidhëse 400 KW në mes të Kosovës dhe të Shqipërisë;
8. Të përkrahet fuqishëm strategjia që kuadrot vendase në të gjitha nivelet të udheheqin KEK-un, ndërsa kuadrot ndërkombëtare të marrin rolin e këshilldhënësve;
9. Të përkrahet projekti KEK-PO, për rritje të efektit veprues dhe financiar;
10. Të autorizojë Kuvendi Qendror për Hetime Financiare (FIU) për hetimin e keqpërdorimeve eventuale në KEK.

Edhe pas këtyre rekomandimeve, situata në sektorin e energjisë vazhdoi të mbetet pothuajse e njëjtë. Vazhdon mungesa me furnizim të energjisë elektrike dhe ngrohje. Furnizimi i amvisërive ende nuk është stabilizuar. Edhe përkundër përpjekjeve për zgjidhjen e këtij problemi, asnjë nga këto iniciativa nuk rregulluan çështjen e furnizimit me energji. Madje u paraqit edhe një problem tjetër: pamundësia e KEK-ut për t'i inkasuar mjetet për energjinë e prodhuar, rezultoi në transferimin e fondeve të mëdha nga suficitit i buxhetit nga ana e UNMIK-ut tek KEK-u,



Bajrush Xhemaili

transfere këto të cilat nuk u autorizuan nga Kuvendi.

Në fillim të dhjetorit 2003, Komisioni ynë gjatë një takimi vendosi të fillojë hartimin e legjislacionit për energjinë, të cilën iniciativë ia drejtoi Kryesisë së Kuvendit. Ne kërkuam ndihmë nga ekspertët dhe donatorët e ndryshëm që veprojnë në Kuvend, si USAID-i dhe AER-i, të cilët shfaqën gatishmërinë e tyre për të na ndihmuar. Veç kësaj, ne i ftuam edhe të gjitha palët nga sektori publik dhe privat, që të marrin pjesë në grupin punues. Pas kësaj, Komisioni emëroi anëtarët e grupit punues.

Procesi i hartimit në Kuvend ishte jashtëzakonisht i suksesshëm. Kështu, grupi punues i Komisionit për Tregti dhe

Industri mbajti mbledhje të hapura dhe transparente nga tri herë në javë gjatë tre muajve të shkuara. Së këndejmi, ne ia dolëm mbanë që ta përfundojmë projektligjin e parë, i cili përfshinë tre ligje, Ligjin për Organin Rregullues të Energjisë, Ligjin për Energji dhe Ligjin për Energji Elektrike. Vlen të theksohet se këto ligje janë të bazuara në legjislacionin slloven, kroat, boshnjak, polak, hungarez dhe bullgar dhe janë në përputhje me direktivat e BE-së dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të Athinës, ku është pjesëmarrëse edhe Kosova. Në përgjithësi këto ligje, do të bëjnë të mundur që Kosova të bëhet pjesë e tregut konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë.

Shpëtimi i demokracisë

Në muajin janar Komisioni për Financa dhe Ekonomi i Kuvendit, mbajti për herë të parë një dëgjim publik për të shqyrtuar projektligjin mbi themelimin e Odës së Ekonomisë të Kosovës. Me këtë rast, zëvendëskryesuesi i komisionit, Z. Fatmir Rexhepi, vuri në dukje se ky test i demokracisë nxorri në shesh pikëpamjet e komunitetit të biznesit të Kosovës.

Nga Xhef Bjeli, zëvendës i zëdhënësit të OSBE-së

“Ne dëshirojmë të trajtohem si partnerë në zhvillimin e biznesit në Kosovë,” deklaroi Z. Rexhepi. “Për ne ishte me interes që të merrim opinionet dhe pikëpamjet e secilit prej tyre mbi parimet e hartimit të ligjit.”

S’do mend, ishte e natyrshme që të ftohej komuniteti i biznesit “për t’iu drejtuar komisionit të Kuvendit”, vazhdoi ai, ngase projektligji, i cili po shqyrtohej ishte në interes të tyre. “Nuk mund ta bënim dot këtë pa ndihmën e tyre. Ky është një ligj që ka të bëjë me një komunitet tjetër. Andaj, na nevojitej pjesëmarrja e anëtarëve të komunitetit të biznesit.”

Në këtë sesion, morën pjesë shumë përfaqësues të kompanive kosovare, me ç’rast shfrytëzuan këtë mundësi për të shfaqur pikëpamjet e tyre si dhe për t’i adresuar disa nga çështjet kryesore të këtij projektligji, të hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në vazhdim, Z. Rexhepi e parashtrroi mendimin e tij se njëra nga çështjet kryesore ishte se a duhet të jetë e obligueshme pagesa e anëtarësisë në Odën e Ekonomisë për të gjitha bizneset kosovare, numri i të cilave, theksoi ai, “arrinë deri në 50.000”. Sipas draftit të përgatitur nga ministria, të gjitha bizneset do të duhej të anëtarësohen në Odë dhe ta paguajnë anëtarësinë.

Ky sistem është bazuar në modelin e veprimtarisë së odave tregtare të vendeve të zhvilluara evropiane, si Franca dhe Gjermania. Njëherazi, ai bëri të ditur se shumica e vendeve të Ballkanit kanë asociacione të biznesit, të organizuara në baza

vullnetare, ku secila kompani është e lirë të zgjedhë në dëshiron apo jo të anëtarësohet në Odën lokale të Ekonomisë dhe të paguajë kuotën e anëtarësisë. Gjatë këtij shqyrtimi publik, përfaqësuesit e komunitetit të biznesit vunë në spikamë se qasja e këtij ligj ishte mjaft jofleksibile, meqë atyre u është rrëmbyer e drejta për të vendosur për mënyrën e organizimit të Odës Ekonomike.

Z. Rexhepi shprehu të njëjtin mendim lidhur me këtë ligj, duke vënë në pah se ligji duhet t’i “mbrojtë interesat e biznesit dhe jo të shtetit, i cili ka miratuar mjaft ligje në përputhje me interesat e tyre.”

Së këndejmi, sipas tij, komisioni po e shqyrton mundësinë për përfshirjen e një amandamenti në këtë ligj, që do t’ia bënte të mundur Odës Ekonomike të mbajë një referendum të biznesmenëve lidhur me anëtarësinë e obligueshme. “Kjo është mënyra më demokratike”, tha ai, “e cila do t’ia bëjë të mundur Odës Ekonomike për të gjetur mënyrën më të përshtatshme, për të vendosur se cila është zgjidhja më e mirë për ta.”

Njëherësh, me këtë rast u trajtua edhe rregullorja e Odës, dhe mënyra e zgjedhjes së udhëheqësisë. Edhe lidhur me këtë çështje, u dhanë sugjerime mjaft të rëndësishme, me qëllim të përmirësimit të draft-ligjit dhe të korrigjimit të dispozitave, për të cilat disa pjesëmarrës patën përshtypjen se ato mund të krijonin një organizatë të centralizuar me një udhëheqësi tejet të fortë.

Veç kësaj, projektligji në versionin e tij të parë bën fjalë vetëm



Fatmir Rexhepi

për Odën Ekonomike, ndërsa gjatë shqyrtimit publik u tha se draft-ligji lypset të ndryshohet, në mënyrë që të jetë më gjithëpërfshirës. Z. Rexhepi shprehu bindjen e tij se edhe kësaj radhe pikëpamjet e krerëve të biznesit ishin jashtëzakonisht të dobishme gjatë përgatitjes së ligjit, ngase theksoi ai: “Ato jo vetëm që nuk ia mbyllin derën konkurrencës, po përkundrazi ia hapin derën asaj.”

“Në këtë ligj duhet të përfshihen jo vetëm Oda Ekonomike por edhe asociacionet tjera të biznesit,” pohoi ai. “Me një fjalë, Oda nuk duhet ta ketë monopolin.”

Tani, me kthimin e projektligjit në komision për rishqyrtim, do të bëhet përfshirja e sugjerimeve të qarqeve të biznesit në këtë ligj. “Ne dëshirojmë ta bëjmë ligjin më transparent, më demokratik dhe më të përshtatshëm për komunitetin e biznesit,” vuri në pah zëvendëskryesuesi.

Ç’është e vërteta, organizimi i

dëgjimeve publike për projektligje, ka treguar se procesi i hartimit të ligjeve është një parakusht i domosdoshëm për të ngritur cilësinë e punës së Kuvendit. Duke bërë të mundur shkëmbimin e ideve dhe parimeve me palën për interesat e së cilës është fjala, komisioni krijoi mundësitë për një përfaqësim sa më të denjë të tyre.

“Përmes këtij dëgjimi publik” shtoi ai, “iu shporëm ndikimit të politikës. Pra, ne bëjmë të mundur që politikën ta mbajmë larg nga organizimi i tyre.”

Ndonëse, ka të ngjarë që drafti të pësojë ndryshime thelbësore, zëvendëskryesuesi ua rikujtoi të pranishmëve se është detyrë e deputetëve të vendosin për këtë. “Ne, si deputetë të Kuvendit, duhet ta ndjekim patjetër këtë rrugë për të provuar se jemi demokratë, madje edhe nëse kjo është në pajtim me atë që ka përgatitur ministria.”

Tek e mbrama, “Ligji është i Kuvendit,” përfundoi Z. Rexhepi.

Strategjia legjislative e Kosovës deri më tetor të vitit 2004

Një nga detyrat kryesore të qeverisë së Kosovës është hartimi përfundimtar i kornizës legjislative, që do të mundësonte jetë dhe punë normale në Kosovë. Është e qartë se programi legjislativ i qeverisë, për dallim nga fillimi i vitit 2002, kur është aprovuar nga Kuvendi, ka ndryshuar dukshëm. Një numër i projektligjeve nuk janë procesuar ende nga qeveria dhe Kuvendi, përderisa - fatmirësisht - ka pasur raste kur orientimet e programeve janë përmbushur më herët se sa ishte pritur. Duke marrë parasysh se gjatë këtij viti u bartën kompetencat tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), një strategji e re legjislative u bë domosdoshmëri. Strategjia legjislative e qeverisë për periudhën tetor 2003 - tetor 2004 është padyshim njëra nga aktet më të rëndësishme që janë miratuar nga qeveria në kohët e fundit.

Azem Hajdari, Secretary to the Government

Propozimi për përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm, inicuar nga Zyra e Kryeministrit, i është dorëzuar qeverisë së Kosovës më 12 shtator 2003. Qeveria e Kosovës e aprovoi këtë propozim në takimin e mbajtur më 17 shtator 2003. Pastaj, Kryeministri i Kosovës nënshkroi vendimin nr. 69/4, të datës 22 shtator 2003, mbi formimin e grupit punues për hartimin e strategjisë. Anëtarët e grupit punues, përfshirë akterët kryesorë të politikës legjislative në Kosovë (Zyrën e Kryeministrit, ministrat, Kuvendin, si dhe shoqërinë civile), pas një pune intenzive, arritën që ta përgatisin këtë dokument, të cilin qeveria e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 15 tetor 2003. Strategjia legjislative e qeverisë për periudhën e lartpërmendur, përcakton kornizën për hartimin e 119 ligjeve, prioritetet legjislative të Kosovës, obligimet e akterëve të ndryshëm dhe afatet e realizimit të këtyre prioritetëve. Ia vlen të theksohet fakti se kjo strategji është mjaft fleksibile, ngase nuk paraqet pengesë për iniciativat tjera legjislative, nëse ato do të konsideroheshin të nevojshme nga akterët legjislativë të Kosovës. Me këtë rrjedhë korrespondon edhe fakti se, kohëve të fundit, qeveria ka aprovuar tri nisma ligjore të cilat nuk janë parashikuar me strategjinë e aprovuar. Shembull tipik për këtë paraqet projektligji mbi huazimet ndërkombëtare.

Ekzistojnë disa arsye me të cilat mund të justifikohet nevoja e përgatitjes së kësaj strategjie legjislative për qeverinë e Kosovës. Me rastin e formimit të qeverisë, u pa se pjesës së programit legjislativ të aprovuar në Kuvend, që kishte të bënte me legjislacionin, i skadonte afati më 31 tetor 2003. Programi fillestar legjislativ i qeverisë, në disa elemente të tij, është vlerësuar i mangët. Duket shesht se programi i qeverisë, sa i përket fushës legjislative, është punuar me ngut dhe në kohën kur institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes ishin në fazat e para të konsolidimit të tyre. Aso kohe, kishte fare pak ekspertë vendës. Edhe ata që ishin, qenë angazhuar fare pak ose aspak në përgatitjen e tij. Rrethanat në Kosovë tashmë kanë ndryshuar; prandaj përcaktimi i prioritetëve legjislative konsiderohet domosdoshmëri e kohës.

Në përputhje me Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë dhe me qëllim të përsheptimit të bartjes së kompetencave, përplotësimi i infrastrukturës ligjore, që tash për tash është kompetencë e Misionit të OKB-së në Kosovë, paraqet një domosdoshmëri.

Strategjia legjislative e Kosovës për periudhën tetor 2003 deri më tetor 2004, pritet të ketë efekte të shumta dhe të llojllojshme. Ne po i nënvijëzojmë disa nga

ndikimet më të rëndësishme që mund t'i ketë kjo strategji:

I pari - Me ligjet të cilat janë identifikuar si prioritetet e strategjisë legjislative të qeverisë, Kosova, në shumë fusha do t'ia arrijë që të rregullojë një sërë marrëdhënesh të rëndësishme të jetës shoqërore;

I dyti - Këto ligje do t'i japin fund vakumit legjislativ, zbrazëtirave të shumta ligjore, dhe zbatimit të një vargu të ligjeve të Serbisë dhe ish-Jugosllavisë në territorin e Kosovës;

I treti - Duke siguruar se janë konform standardeve të BE-së, ligjeve të vendeve anëtare të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare në përgjithësi, këto ligje do të luajnë një rol të rëndësishëm në inkuadrimin më të përsheptuar të Kosovës në intergrimet evropiane e më gjerë;

I katërti - Efekti i katërt është, gjithësesi, i natyrës politike, sepse këto ligje do ta shpiejnë Kosovën drejt ardhmërisë së saj të dëshiruar;



Kryeministri Bajram Rexhepi

I pesti - Kjo gamë ligjesh do të ketë efekt të rëndësishëm edhe në realizimin e interesave të qytetarëve të Kosovës, sepse ata, për herë të parë, do t'i konsiderojnë këto ligje si ligje të vendit të tyre, dhe

I gjashti - Këto ligje do të ofrojnë kushte adekuate për plotësimin e nevojave kolektive dhe individuale të qytetarëve të Kosovës, ngase me anë të tyre do të rregullohen sfera të rëndësishme të jetës në Kosovë, përfshirë atë ekonomike, sociale, mjedisore etj.

Vizitë studimi në Parlamentin e Belgjikës dhe në Parlamentin Evropian

Në javën e dytë të dhjetorit të vitit 2003, një delegacion i përbërë prej dy deputetëve të Kuvendit dhe pesë anëtarëve të stafit të Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës, vizitoi Dhomën e Përfaqësuesve të Belgjikës dhe Parlamentin Evropian në Bruksel. Qëllimi kryesor i kësaj vizite studimi ishte që të ofrohet një prezantim praktik i sistemeve të dëshmuara elektronike për menaxhimin e dokumenteve elektronike (SMD-ve) në një mjedis shumëgjuhësor. Kjo vizitë ua mundësoi pjesëmarrësve që të marrin informata të hollësishme lidhur me filozofinë dhe kulturën parlamentare, mjedisin e punës dhe praktikën e ndërveprimit me kuadrot e Sekretariatit të Parlamentit të Belgjikës.

By Roger F. Roy,

Project Manager, SPEAK Project in Support of the Assembly of Kosovo, Inter-Parliamentary Union/UNDP-Kosovo

Delegacioni u prit ngrohtësisht nga Sekretari i posazgjedhur i Përgjithshëm i Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës, Z. Robert Mitenare. Gjatë vizitës studiuese, u pa qartë se Z. Mitenare dhe stafi i tij nuk kursenin përpjekjet e tyre për përgatitjen e një programi të detajuar që trajtonte nevojat e delegacionit të Kosovës në kontekst të Projektit për mbështetje arkivave elektronike të Kuvendit të Kosovës (SPEAK). Ecejaket nëpër korridorët e kaluara ndërmyet takimeve të zhvilluara u dëshmuar se ishte përvojë e pasur për delegacionin. Korridorët dhe sallat e shumta që e lidhnin ndërtesën e Dhomës së Përfaqësuesve me atë të Senatit, tregojnë trashëgiminë e pasur kulturore të Belgjikës, përfshirë historinë e Parlamentit të saj, të themeluar në vitin 1830. Kjo kulturë portretizohej nga një sërë veshjesh dekorative në mur, pikturash të vjetra, skulpturash e veprash të artit antik.

Programi ishte përgatitur në atë mënyrë sa që të gjithë anëtarëve të delegacionit nga Kosova, u bëri të mundur, që të përfitojnë informata të dobishme dhe njohuri praktike lidhur me mënyrën e saktë të funksionimit të një Parlamenti në "botën elektronike", duke marrë si kriter sistemin e menaxhimit të dokumenteve në Parlamentin e Belgjikës.

Dita e parë

Pas një prezantimi të sistemit legjislativ belg dhe të procedurave të tij, delegacioni qëndroi për një kohë të gjatë në Bibliotekën e Parlamentit të Belgjikës, ku bëhej menaxhimi i numrave të dokumenteve, mikrofilmimi dhe skanimi i dokumenteve për ndërtimin e bazave të të dhënave. Pasdite delegacionit iu bë një prezantim lidhur me rolin e teknologjisë informative në tërë procesin e ligjvënies. Kjo u përcoll nga një takim plot gjallëri me grupin punues parlamentar të Ministrisë së Politikës Shkenore. Zyrtarët e kësaj ministrie ia prezantuan delegacionit rezultatet shumë pozitive të një ankete, që ishte zhvilluar kohët e fundit në nivel kombëtar, e që kishte të bënte me atë se sa qytetarët e pranorin sistemin elektronik të votimit publik. Në fund të ditës u prezantuan të gjitha aspektet administrative të projektligjeve, iniciativave ligjore dhe amendamenteve legjislativë.

Dita e dytë

Puna e mëngjesit filloi me prezantimin e Divizionit parlamentar për dokumente dhe arkiva, duke iu referuar punës që bëhej në këtë divizion. Sesioni u dëshmuar i sukseshëm, posaçërisht për bibliotekarët e Ko-



Delegacioni i Kosovës gjatë vizitës së tij në Parlamentin e Belgjikës në Bruksel.

sovës, Znj. Memishi dhe Znj. Shukriu, anëtare të Kuvendit me përvojë pune në arkiv. Pasi një sesion tjetër, ku u diskutua mbi sistemin e tanishëm të numërimit dhe digjitalizimit të arkivave dhe dokumenteve të Parlamentit. Pasdite, u bënë disa prezantime mbi mbajtjen digjitale të procesverbaleve dhe përdorimin e "Digivoksit" për mbajtjen e procesverbaleve nga mledhjet e komisioneve. Në fund, u organizua një vizitë në shtëpinë botuese të Parlamentit të Belgjikës.

Dita e tretë

Delegacionit iu ofrua një prezantim shumë i dobishëm mbi shfrytëzimin e teknologjisë informative për përkthimin e dokumenteve parlamentare dhe krijimin e një qendre të bazave

të të dhënave, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e legjislationit belg.

Sesioni i pasditës iu dedikua një vështrimi të thellë mënyrës së përpilimit të teksteve për sesionet legjislativë dhe instrumenteve administrative që shfrytëzohen në përgatitjen e tyre. Pjesëmarrësve iu prezantua mënyra se si kjo punë kryhej në kompjuterët e stafit të parlamentit belg.

Dita e katërt

Dhoma e përfaqësuesve e Belgjikës mbajti një sesion të veçantë mëngjesi me përfaqësuesit e Këshillit Shtetëror të Belgjikës, i cili mbikëqyrë ligjshmerinë e të gjitha ligjeve që propozohen nga ministrat belg në nivelet federale dhe shtetërore.

Pasditja iu kushtua një vizite në Parlamentin Evropian, që në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar, ishte përgatitur enkas për këtë delegacion. Prezantimet u ofruan nga Drejtori i Përgjithshëm i Sektorit për parlamente dhe asamble kombëtare, që nuk janë anëtare të Parlamentit Evropian. Sesionet tjera u përqëndruan në punën e Byrosë së Sekretariatit, ndërsa një vizitë tjetër iu bë Qendrës së dokumenteve parlamentare. Pasditja u përmbyll me një takim mjaft të gjallërishtë, ku morën pjesë edhe Z. Xhefri Haris dhe Znj. Sabina Mazi-Zisis nga Byroja e Evropës Juglindore. Mandej pasoi, një diskutim i thellë dhe i sinqertë mbi gjendjen në Kosovë, i cili u përmbyll me disa prezantime të shkëlqyeshme nga Z. Fatmir Sejdiu, deputet i Kuvendit dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe nga Znj. Edi Shukriu, deputete e Kuvendit të Kosovës.

Dokumentet dhe prezantimet

Si rezultat i vizitës studiuëse në Bruksel, u mblodh një grumbull i dokumenteve mjaft të dobishme dhe praktike në gjuhën angleze dhe frënge. Ky material po përpunohet në një bazë të dhënave duke iu referuar faqeve të internetit, të cilat Dhoma e Përfaqësuesve e Belgjikës, Senati i Belgjikës dhe Bashkësia Evropiane, na i kanë sugjeruar për referencë.

Në fjalën e tij përmbyllëse, Z. Sali Rexhepi, kryesues i Sektorit plenar dhe procedural (Zyra e Parashtrësive), bëri një rezymë për vizitën studiuëse në Bruksel, duke vlerësuar se: "Ne përfituam njohuri të çmueshme lidhur me mënyrën e funksionimit të Dhomës së Përfaqësuesve e Belgjikës, mbi mënyrën e procesimit të ligjeve dhe shfrytëzimit të teknologjisë informative në përgatitjen, korrigjimin dhe shpërndarjen e dokumenteve parlamentare."

Anëtarët e Komisionit të Kuvendit vizitojnë kolegët e tyre në Sarajevë

Në kuadrin e vizitave për shkëmbim rajonal, Fondacioni Fridrih Ebert Shtiftung FES, tok me Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, organizoi një vizitë në Sarajevë. Vizita u zhvillua prej 29 nëntorit deri me 3 dhjetor të vitit 2003, pikërisht në kohën kur procesi i privatizimit në Bosnje dhe Hercegovinë po kalonte nëpër fazën e rishqyrtimit të tij. Me këtë rast, vlen të theksohet se delegacionin e udhëhoqi në mënyrë mjaft profesionale kryesuesja Stojanka Petković.

Besa Luzha, Koordinatorë e programit të FES-it për Kosovë.

Për situatën ekonomike, politike dhe sociale si në Kosovë ashtu edhe në Bosnje e Hercegovinë, mund të thuhet se ka mjaft ngjashmëri. Pikë së pari, këto vende kanë një histori të përbashkët gjatë kohës sa kanë qenë pjesë të ish Jugosllavisë. Të dy vendet përbëhen nga grupe të ndryshme etnike dhe duhet të sigurojnë një qeverisje të ekuilibruar. Njëherësh, situatë mjaft të ngjashme këto dy vende kanë edhe në sferën e punësimit, sistemit social dhe zhvillimit ekonomik, ndonëse Bosnja dhe Hercegovina ka shënuar përparime në disa reforma. Ajo që më së shumti na interesonte me këtë rast ishte që deputetët e Kosovës të përfitojnë nga përvoja në procesin legjislativ, ku të tri komunitetët etnike punojnë së bashku në nivelin federativ. Vetë fakti se edhe Bosna dhe Hercegovina ka kaluar nëpër periudhën gjatë së cilës një mision i KB-ve ishte i përfshirë në krijimin e politikave dhe administrimin e vendit, paraqiste një sfidë për delegacionin, e cila do t'ju bënte të mundur që të kuptonin më lehtë sistemin që mund të barabitet me atë në Kosovë.

FES ka mbajtur kontakte për një kohë të gjatë me Parlamentin e Bosnje dhe Hercegovinës për të mundësuar organizimin e këtyre takimeve, të cilat ne menduam se do të ishin shumë të dobishme për delegacionin nga Kosova. Përbërja e delegacionit ishte proporcionale si sa i takon përfaqësimit partiak ashtu edhe atij

etnik. Delegacioni përbëhej nga 8 anëtarë të Kuvendit, një përkthyes dhe koordinatori i FES-it nga Prishtina.

Për të qenë vizita sa më e suksesshme, ne kësaj radhe vendosëm që të përqëndrohemi vetëm në një komision të Kuvendit të Kosovës, Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, me ç'rast u përcaktuam për takimin me dy komisionet nga Sarajeva, Komisionin për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisionin për Invalidë, Veteranë të Luftës dhe Persona të Zhdukur.

Ne arritëm në Sarajevë pikërisht në kohën kur këto komisione ishin duke rishqyrtuar procesin e privatizimit në Bosnje dhe Hercegovinë. Delegacioni pati rastin që të takojë me kryesuesit dhe me anëtarët e komisioneve. Njëherësh, ky delegacion pati nderin që të marrë pjesë në seancën plenare të Parlamentit të Bosnje dhe Hercegovinës, me ftesë të kryetarit të këtij Parlamenti, Z. Muhamed Ibrahimović, i cili e shoqëroi delegacionin gjatë tri netëve dhe mori pjesë aktivisht në diskutime. Me këtë rast, ekspertët boshnjakë shprehën gatishtërinë e tyre të plotë për t'iu ndihmuar kolegëve të tyre nga Kosova.

Më pas, delegacionin nga Kosova e pranoi edhe zëvendësimin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, i cili i informoi jo vetëm lidhur me situatën e përgjithshme në sferën e punësimit,

sistemit social, pensione, por edhe për çështje të tjera. Një takim tjetër me rëndësi ishte ai me grupin punues pranë Bordit të Ministrave të Qeverisë, cili merret me Strategjinë për Uljen e Varfërisë dhe Zhvillim, të përfaqësuar nga Z. Haris Mesinović, ish Ministër i Punës.

Delegacioni pati rastin që të furnizohej me shumë materiale nga Parlamenti Federal dhe nga ministrat të cilët i vizituan, përfshirë këtu edhe draftin mbi strategjinë e sipërpërmendur. Së këndejmi, i tërë legjislacioni i Bosnjës nga kjo lëmi tani është në dispozicion të deputetëve të Kosovës.

Vlen të theksohet se delegacionin e kryesoi Znj. Stojanka Petković, anëtare e Kuvendit nga "Koalicioni Kthimi". Ajo e udhëhoqi delegacionin në mënyrë mjaft konstruktive, duke iu shporur diskutimeve përçarëse dhe duke nxitur debate kuptimplote për çështje profesionale. Njëherazi, ajo prezantoi në mënyrë të paanshme punën, problemet, rezultatet dhe sfidat e komisionit të saj. Ndonëse ishte e rastit që delegacioni përbëhej kryesisht nga gratë, kjo bëri që faktori gjinor të luaj një rol pozitiv në mbarëvajtjen e vizitës.

Parlamentarët nga Prishtina dhe Sarajeva ranë dakord që ta vazhdojnë bashkëpunimin. Ndërkaq, koncepti i vizitës nga FES-i, u vlerësua nga të dy palët si profesional dhe përmbytësor, andaj edhe ia vlen të vazhdohet.

Rregullorja e Punës së Kuvendit: Një azhurim

Të gjithë anëtarët e një organi ligjvënës duhet ta kuptojnë rregulloren sipas së cilës vepron dhoma në mënyrë që çdo organ ligjvënës të jetë i efektshëm. Pa rregullore të qartë dhe të përgjithshme, organi ligjvënës do të përballet me shumë procedura dhe, eventualisht, beteja politike.

Nga Kevin Deveauks,
Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)



Kevin Deveauks

Kuvendi i Kosovës është mbledhur menjëherë pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2001. Për të ndihmuar seancën e përrurimit të Kuvendit, UNMIK-u ka hartuar Rregulloren e përkohshme të punës e cila është përdorë nga Kuvendi deri në hartimin dhe përpunimin e rregullores së korrigjuar. Ishte e qartë se Rregullorja e përkohshme e punës do të përdorej nga Kuvendi i Kosovës për një kohë të shkurtë.

Në verën e vitit 2002, Kuvendi ka emëruar një grup punues të anëtarëve të Kuvendit për të hartuar Rregulloren e re të punës. Grupi udhëhiqej nga Arsim Bajrami dhe përbëhej nga Fatmir Sejdiu, Nekibe Kelmendi, Bajram Kosumi, Muhamet Kelmendi dhe Dragisha Kërstoviq. Mandati i grupit punues ishte të mos rishkruhen të gjitha pikat e Rregullores së përkohshme të punës, por të bëhet përmirësimi i Rregullores së punës duke

siguruar që rregullorja të jetë në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) ka punuar me Kuvendin e Kosovës që nga koha kur është themeluar në fund të vitit 2001. Përmes Iniciativës për Mbështetje të Kuvendit (ASI) dhe me ndihmën e USAID-it, NDI-ja i ka ofruar mbështetje teknike grupit punues në hartimin e Rregullores së re të Punës.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2002, grupi punues është takuar rregullisht për të diskutuar ndryshimet e Rregullores. Një nga çështjet e veçanta të anëtarëve të Kuvendit ishte të ngritet aftësia e banorëve të Kosovës për pjesëmarrje në proceset legislative, qoftë përmes shqyrtimeve publike qoftë përmes paraqitjes së peticioneve. Shqyrtimi i Rregullores përfundoi në dhjetor të vitit 2002 dhe versioni i ripunuar iu paraqit Kuvendit në janar të vitit 2003. Rregullorja e korrigjuar e punës është miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të mbajtur më 9 janar të vitit 2003.

Pjesët më të rëndësishme të ndryshimeve të Rregullores së punës përfshijnë:

- Takimet e komisionit janë paraparë të hapen për opinionin publik, përveç në rrethana shumë të kufizuara.
- Anëtarët kanë të drejtë të paraqesin interpelancë - një

mënyrë për të detyruar qeverinë për të dhënë shpjegime për vendimet specifike të politikave.

- Janë caktuar afatet për të vënë dokumentet në dosje dhe mocionet me Kuvendin, duke i siguruar përkthimet me kohë.
- Komisionet dhe anëtarët individual kanë të drejtë të hartojnë ligjet dhe t'i paraqesin projekt-ligjet në Kuvend për debat.
- Grupet Parlamentare kanë më shumë pushtet dhe përgjegjësi.
- Një ministër mund të jetë i detyruar të marrë pjesë dhe të dëshmojë në një seancë të komisionit.
- Komisionet ad hoc mund të themelohen për të hetuar çështjet specifike.
- Mandatet e të gjitha komisioneve janë cekur në detaje në një shtojcë të Rregullores.

Kuvendi i Kosovës e konsideron Rregulloren e punës si një dokument intern që nuk kërkon aprovim nga PSSP-ja. Mirëpo, UNMIK-u ka mendim tjetër dhe në shkurt të vitit 2003, UNMIK-u kishte vërejtje për shtatë çështje në Rregulloren e korrigjuar. UNMIK-u nuk ishte i gatshëm të nënshkruajë Rregulloren e korrigjuar derisa të bëhen ato shtatë ndryshime. UNMIK-u ishte i shqetësuar me ato ndry-

shime, ngase mendonte se kishin cënuar Kornizën Kushtetuese.

Në mars të vitit 2003, Zyra për Çështje Ligjore (ZÇL) e UNMIK-ut dhe Kuvendi janë takuar për të diskutuar gjetjen e një zgjidhjeje për gjendjen e krijuar. Në atë takim është arritur një progres dhe janë zgjidhur katër nga shtatë çështjet. Kuvendi është pajtuar të ristrukturojë grupin punues për të shqyrtuar shtatë çështjet dhe të rekomandojë ndryshime të mëtejshme për Rregulloren e korrigjuar të punës. Grupi Punues i raportoi Presidencës dhe Kuvendit në tetor të vitit 2003. Kuvendi aprovoi ndryshimet e Rregullores për të reflektuar shumë prej çështjeve të UNMIK-ut.

Mirëpo, nuk janë adresuar të gjitha çështjet e UNMIK-ut. Për këtë arsye Rregullorja e Punës e korrigjuar nuk është aprovuar ende nga PSSP-ja. Kuvendi akoma mbështetet në Rregulloren e punës kur e udhëheqë punën e vet. Shpresohet se konfuzioni i shkaktuar nga kjo gjendje e paralizuar do të shqyrtohet në një të ardhme të afërt.

Në muajt e ardhshëm, NDI-ja do të punojë me secilin grup parlamentar për t'iu ofruar atyre trajnim për Rregulloren e punës të korrigjuar. Duke iu ofruar mbështetje secilit grup, shpresohet se grupet parlamentare do të rrisin ndikimin e tyre në Kuvendin e Kosovës dhe, njëri pas tjetrit me rend, do të sigurojnë përkrahje për Rregullore të punës nga Kuvendi dhe do të punojnë me më shumë efikasitet.

Fondacioni Fridrih Nauman organizon vizitë pune në Parlamentin e Austrisë

Me datën 9 janar 2003, një delegacion i Parlamentit të Kosovës, i përbërë nga kryetarë dhe anëtarë të Komisionit të financave dhe ekonomisë, tregtisë dhe industrisë dhe Komisionit të buxhetit, bëri një vizitë pune në Austri. Vizitën e këtij delegacioni parlamentar të Kosovës, e organizoi fondacioni Fridrih Nauman, Zyra në Prishtinë. Me këtë rast, delegacioni pati kënaqësinë të takohej me kolegët e komisioneve homologe dhe me kryetarin e dytë të Parlamentit të Austrisë, Z. Hajnc Fisher, me përfaqësuesit e OSBE-së në Vjenë, me organizata konsultative, etj.

Haki Shatri dhe Minire Çitaku

Grupi i parlamentarëve kosovarë pati rastin që të njihet me strukturën, mënyrën e funksionimit dhe me historinë e Parlamentit austriak. Veç kësaj, delegacioni i Kuvendit të Kosovës pati takime të ndara pune edhe me homologët e Austrisë, përfshirë këtu takimet me kryetarë të komisioneve të buxhetit, të ekonomisë si dhe tregtisë.

Gjatë të gjitha takimeve parlamentarë austriakë shprehën dëshirën dhe gatishmërinë e tyre për të vazhduar bashkëpunimin me kolegët e tyre kosovarë përmes kontakteve të ndryshme, me qëllim të vënies në dispozicion të përvojave të tyre, por edhe përmes kontakteve zyrtare në Prishtinë. Njëherësh, vlen të theksohet se bisedit me deputetët austriakë u përqëndruan kryesisht rreth gjetjes së mundësive të reja për një përfshirje më të madhe të ndërmarrjeve austriake në fusha të ndryshme të ekonomisë së Kosovës.

Përfaqësuesit e komisioneve parlamentare të Kosovës gjatë takimit me kolegët e tyre nga parlamenti i Austrisë.

Me interes të veçantë ishte takimi me presidentin shumëvjeçar, tani kryetar i dytë i Parlamentit të Austrisë, Z. Hajnc Fisher. Zoti Fisher në fillim të fjalës së tij, zuri në gojë edhe vizitën e tij në shtatorin e vitit 2002 në Kosovë, të cilën e kishte bërë me ftesë të Kuvendit të Kosovës dhe OSBE-së. Ai njëherësh, vuri në dukje se është i njohur me situatën aktuale në Kosovë. Me këtë rast, përpos konsultimeve dhe shkëmbimit



Përfaqësuesit e komisioneve të Kuvendit të Kosovës takohen me kolegët e tyre nga Parlamenti i Austrisë

të informatave të ndryshme, Z. Fisher iu përgjigj edhe pyetjes së një parlamentar të Kosovës për mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në Bashkësinë Evropiane. Sipas tij, anëtarësimi i Kosovës në BE është, tani për tani në vartësi nga statusi politik final i Kosovës. Zoti Fisher shfaqti shpresën dhe dëshirën e tij për gjetjen e një zgjidhje paqësore dhe të drejtë të kësaj çështjeje. Porosia e fundit e tij përkthet me fazën përfundimtare të zgjerimit të BE-së, ishte se Kosova - tok me disa vende fqinje - duhet të përfshihet në listën e vendeve që do të anëtarësohen në Bashkësinë Evropiane. Në fund të takimit, Z. Fisher dhe Z. Haki Shatri, dhanë një intervistë të përbashkët për agjensinë e lajmeve të Austrisë, ku theksuan rëndësinë dhe rolin e kësaj vizite.

Përveç këtyre takimeve, delegacioni i Parlamentit të Kosovës u prit edhe nga përfaqësuesja e Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Me këtë rast delegacioni pati rastin të mësojë më tepër për shtetin e Austrisë, në përgjithësi dhe për historinë, situatën aktuale dhe sistemin e arsimit, në veçanti.

Një takim tjetër ku parlamentarët e Kosovës u pritën mjaft ngrohtësisht ishte edhe ai që u organizua në selinë e OSBE-së në Vjenë. Gjatë kësaj vizite delegacioni kosovar pati rastin që të njihet më hollësisht me strukturën e kësaj organizate - sidomos me aktivitetin e OSBE-së në Kosovë dhe rajon. Z. Aleksandër Niçe, përgjegjës i OSBE-së për media, bëri një prezantim mbi mënyrën e funksionimit të këtij institucioni, duke theksuar me këtë rast kontributin e çmuar të kësaj organizate për organizimin e zgjedhjeve të fundit vendore dhe të atyre në të ardhmen në Kosovë, si dhe përkrahjen dhe ndihmën që ky institucion ndërkombëtar është duke ia dhënë shkollës policore në Vushtri.

Përpos kësaj, edhe zonja Margret Veber, zëvendës ambasadore pranë përfaqësuesisë së përhershme të Republikës

Federale të Gjermanisë në OSBE, bëri një prezantim të rolit dhe angazhimit të Gjermanisë në organizatën e OSBE-së.

Në mesin e takimeve të shumta që u organizuan së bashku me kolegët nga Parlamenti austriak, vlen të përmendet edhe ai që delegacioni ynë pati me ekspertët austriakë të energjetikës. Në këtë takim sikundër edhe në të gjitha takimet e tjera, delegacioni kosovar pati rastin që të shkëmbejë mendime e përvoja profesionale me këshilltarë kompetentë të

Austrisë. Në këtë takim, u diskutua edhe lidhur me gjendjen aktuale, nevojat, mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të energjetikës, në përgjithësi dhe energjisë elektrike në Kosovë, në veçanti. Pos tjerash, në këtë takim u diskutua edhe për situatën energjetike në vendet fqinje të Kosovës. Në këtë kontekst, u zhvillua edhe një diskutim me ekspertin austriak të energjetikës Dr. Vollker Kier, i cili është njëherësh edhe njohës i mirë i rrethanave të gjithëmbarshme kosovare.

Mënyra se si ishte konceptuar kjo vizitë - kombinimi i njohurive teorike me ato praktike - është vlerësuar shumë lartë nga të gjithë pjesëmarrësit, si vazhdimësi e ndihmës së fondacionit Fridrih Nauman dhënë komisioneve përkatëse që nga konstituimi i Kuvendit të Kosovës.

Se nga njohuritë dhe përvojat e mësuara në Austri, deputetët e komisioneve përkatëse kanë përfituar mjaft, duket sheshit edhe nga angazhimet e tyre që i kanë filluar menjëherë pas kthimit të tyre në Kosovë. Gjatë muajit janar, pritet të organizohet një dëgjim publik mbi rolin, funksionin dhe detyrat e Odës Ekonomike, ndërsa më vonë, përpos tjerash, pritet të nxirret edhe një ligj mbi energjetikën.

Fondacioni Fridrih Nauman, Zyra në Prishtinë, do të vazhdojë angazhimin dhe ndihmën për krijimin dhe ngritjen e institucioneve demokratike në Kosovë si dhe ofrimin e njohurive për krijimin e një ekonomie të zhvilluar në bazë të standardeve të "Asquis Comunitare".

Aktivitetet në mbështetje Kuvendit të Kosovës

Parlamentari gjerman diskuton me politikanët kosovarë lidhur me procesin e vendimarrjes në Parlament

Fridrih Ebert Shtiftung (FES) e ftoi Z. Karsten Shonfeldin, deputet i Bundestag-ut gjerman, që të takohet me politikanët e Kosovës më 29 dhe 30 nëntor 2003 në Gjakovë, për të diskutuar mbi procesin e vendimarrjes në suazën e grupeve politike dhe midis tyre. Në mesin e pjesëmarrësve nga Kuvendi ishin Fatmir Sejdiu, Hydajet Hyseni dhe Naim Maloku, si dhe politikanë nga niveli komunal dhe forumet rinore të partive.

Z. Shonfeld ofroi një pasqyrë të shkurtë për përvojën e tij në organizimin e një grupi të parlamentarëve të rinj, në kuadër të grupit të tij politik. Ai dha disa detaje mbi preokupimet fillestare të udhëheqësisë së partisë dhe përmirësimin e mëvonshëm të proceseve të brendshme të vendimarrjes, si rezultat i strukturimit të diskutimeve të brendshme me konsensus. Ky grup pastaj debatoi mbi mundësitë e zbatimit të përvojave të tij në situatën politike në Kosovë si dhe gjetjen e zgjidhjeve politike për çështjet si arsimit, mjedisi, zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit dhe integrimi në Evropë.

Kuvendi lansoi faqen e tij të internetit

Divizioni për Media dhe Publikime i Kuvendit të Kosovës pritet ta lansojë faqen e internetit të Kuvendit gjatë muajit shkurt të vitit 2004. Kjo do të jetë faqja e parë zyrtare e internetit që lanohet nga IPVQ-të. Faqja e internetit përmban të dhënat mbi deputetët e Kuvendit, si dhe materiale lidhur me strukturën dhe Sekretariatit e Kuvendit. Në këtë faqe do të përfshihen edhe ligjet që janë aprovuar deri më tash nga Kuvendi dhe një kalendar i aktiviteteve të tanishme të Kuvendit. Përmes kësaj web-faqeje, synohet të shtohet dukshmëria dhe transparenca e Kuvendit të Kosovës. Kjo web-faqe është dizajnuar nga kompania vendase "Rrota Interactive". Projekti është mbështetur nga Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së.

Program televiziv mbi punën e Kuvendit të zhvilluar gjatë vitit 2003

Cilat janë vendimet më të rëndësishme që janë marrë nga Kuvendi gjatë vitit të kaluar? Çfarë do të ndikonte në përmirësimin e veprimtarisë së Kuvendit? Sa janë vetë deputetët e Kuvendit kritikë ndaj punës së Kuvendit? Çfarë u shkakton deputetëve më shumë telashe në punën e tyre, me çfarë sfidash ballafaqohen ata?

Këto ishin pyetjet, të cilat gazetarët e mediave të shkruara dhe elektronike nga RTK-ja, KTV-ja dhe Bota Sot, ua drejtuan deputetëve të Kuvendit të Kosovës gjatë programit televiziv tridhjetëminutësh, që u drejtua nën udhëheqjen e trajneres Z. Ljerka Bizilj, nga RTV i Sllovenisë. Në këtë program u pasqyrua mënyra se si vlerësohej, kritikohesh apo arsyetohej puna e Kuvendit nga publiku dhe analistët politikë, në kontekstin e kërkesave të elektoratit.

Dy programet e para u përqëndruan më shumë në punën javore të Kuvendit, ndërsa pjesa e tretë dhe e fundit, u fokusua në punën

vjetore të Kuvendit të Kosovës, duke e shikuar atë nga një kënd analitik. Programet u përgatitën në bashkëpunim me ekipin për Mbështetje Mediave dhe atë për Mbështetje Qeverisë Qendrore të Departamentit të Demokratizimit dhe u përqëndruan në ndihmën që duhet t'u ofrohet gazetarëve që përcjellin punën e Kuvendit për t'i zgjeruar njohuritë e tyre dhe për t'i konsoliduar aftësitë që u nevojiten për të përgatitur programe të balancuara që reflektojnë pikëpamjet e partive të ndryshme politike. Në kuadër të projektit ishte paraparë edhe një vizitë në Lublanë për gazetarët që përcjellin punën e Kuvendit të Kosovës, për ta vështruar punën e RTV të Sllovenisë dhe hapësirës programore që i kushtohet Parlamentit të Sllovenisë. Ky udhëtim studimi, që u realizua në tetor të vitit të kaluar, ishte shumë i dobishëm për gazetarët sepse ua mundësoi atyre t'i pasurojnë përvojat e tyre.

Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte që të kontribuohet në ndarjen e një hapësire më të gjërë programore për veprimtarinë e Kuvendit, që, njëkohësisht, të ofroheshin informata shtesë për t'i njoftuar më mirë qytetarët e Kosovës me zhvillimet në arenën politike dhe të shtohet transparenca e Kuvendit në sy të elektoratit (*Lizabeta Paloka*).

Përgatitjet për zbatimin e Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare

Ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare është promulguar nga PSSP-ja në nëntor të vitit 2003. Ky ligj garanton të drejtën e të gjithë banorëve të Kosovës që të kenë qasje në dokumentet publike që gjenden në IPVQ, komuna dhe shumë institucione të tjera qeveritare. Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) bashkëpunoi ngushtë me Zyrën e Kryeminsitrit dhe me disa OJQ, përfshirë IREX-in, që ta përgatisë projekligjin për t'ia dorëzuar Kuvendit Qendror. NDI bashkëpunoi edhe me Komisionin për Shërbime Publike në mbajtjen e seancave publike mbi këtë projekligj.

Tani pasi ky ligj është miratuar, NDI do të ofrojë një trajnim për shërbyesit civilë, deputetët e Kuvendit dhe stafin komunal, për t'u siguruar se ky ligj do të zbatohet si duhet. Ky trajnim do të mbahet nga 16 deri më 20 shkurt 2004. Gjatë vitit 2004, OJQ-të tjera do të ofrojnë trajnime për gazetarë dhe grupe tjera të interesuara.

Zyreve të vendit në Prishtinë iu ofrua një azhurnim mbi zgjedhjet 2004

Më 15 dhjetor, në selinë e OSBE-së në Prishtinë, u mbajt një takim konsultativ me përfaqësuesit e zyreve të vendit. Më këtë rast, Ambasadori Paskal Fieski ofroi një azhurnim mbi rrjedhën e përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2004, duke bërë të ditur se ende nuk ishte caktuar ndonjë datë konkrete për ditën e zgjedhjeve. Zyrtarët nga Departamenti i Zgjedhjeve përmendën themelimin e Sekretariatit të KQZ-së dhe sfidën e bartjes së përgjegjësisë për operacionet e zgjedhjeve tek ky organ i pavarur i formuar kohë më parë. Zyrtarët e Ekipit për Mbështetje Qeverisë Qendrore shpjeguan në vija të trasha aktivitetet me fokus të veçantë mbështetjes që i ishte ofruar Kuvendit që nga themelimi i tij dhe paraqiti prioritetet për vitin 2004. Ata thanë se në mesin e këtyre prioritetëve, më i rëndësishmi është koordinimi i

programeve të ndihmës ndërkombëtare për Kuvendin e Kosovës, në kuadër të Iniciativës për Mbështetje Kuvendit të Kosovës, (ASI-it). Organizatat partnere të ASI-it prezantuan prioritetet e tyre në mbështetje Kuvendit të Kosovës për vitin 2004, ndërsa me përfaqësuesit e zyrave të vendit, diskutuan mbi çështje të ndryshme në lidhje me politikën. Në mesin e çështjeve që u shqyrtuan ishte edhe kërkesa e madhe për punë legjislative me të cilën ekzekutivi e ka ndërmend ta ngarkojë Kuvendin gjatë vitit të ardhshëm të zgjedhjeve, çfarë kërkon ndihmë të mëtejme dhe bashkërenditje të sërishme të programeve për mbështetje Kuvendit.

Botohet raporti përfundimtar mbi konferencën në Sarajevë

Nga 2 deri më 4 tetor 2003, parlamentarë nga 11 parlamente të Evropës Juglindore, përfshirë ata të Kuvendit të Kosovës, u takuan në Sarajevë për të debatuar mbi sfidat e përbashkëta në uljen e varfërisë dhe zhvillimin ekonomik. Raporti final mbi këtë konferencë të organizuar nga OSBE-ja u botua në anglisht, serbo-kroato-boshnjakisht, shqip dhe maqedonisht, dhe tash mund të merret në të gjitha zyrat e misioneve të OSBE-së në Evropën Juglindore, përfshirë zyrat e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Botohet Doracaku mbi seancat publike

Gjatë vitit të kaluar, disa organizata partnere të ASI-t kanë inkurajuar dhe kontribuar aktivisht në organizimin e seancave publike të komisioneve të Kuvendit. NDI, afër mendsh, përfshirë kontributin e organizatave të tjera, ka përgatitur një doracak mbi seancat publike. Në këtë doracak përfshihen praktikë me të mira, shembujt, modelet dhe disa këshilla praktike për përgatitjen e seancave publike. Ky doracak është botuar në anglisht, shqip dhe serbisht. Ekzemplarë të këtij doracaku mund të gjenden në zyrat e NDI-së dhe OSBE-së.

Kolegë të rinj në mbështetje të Kuvendit

Disa kuadro të reja kanë hyrë në organizatat që punojnë me Kuvendin. Znj. Doina Gimici (nga Rumunia) dhe Z. Uli Shtajnlj (nga Gjermania) i janë bashkuar Ekipit për Mbështetje Qeverisë Qendrore pranë Departamentit të Demokratizimit të OSBE-së. Z. Patrik R. Kedëll (nga SHBA-të) u emërua drejtor programi për mbështetje legjislative në NDI. Ne presim me kënaqësi që të punojmë së bashku me ta, në të mirë të Kuvendit.

Buletini Civic Herald

Buletini i ASI-it mirëpret edicionin e parë të bonjakut të tij elektronik, Civic Herald, mediumit elektronik të Projektit dialogu civil. Projekti për dialog civil po implementohet nga Shoqata Nëna Terezë nga Prishtina dhe nga Qendra për Rajonalizim e Novi Sadit, me ndihmën e Departamentit për Demokratizim të OSBE-së, fondacionit Freedom House dhe fondit Rockefeller Brothers.

Civic Herald-i synon promovimin dhe informimin e publikut lidhur me iniciativat për dialog civil në rajonin e EJK-së, me fokus të veçantë në Kosovë dhe Serbi. Civic Herald do të publikohet, çdo dy muaj, në tri gjuhë, në anglisht, shqip dhe serbisht. Ju mund ta lexoni këtë buletin në www.osce.org/kosovo dhe së shpejti edhe në faqen që do të krijohet nergut për Projektin për dialog civil: www.civil-dialogue.org. Për komente apo kërkesë për abonim, lu-teni të kontaktoni me: mario.maglov@omik.org

vijimi i faqës 15

Mbase më i rëndësishmi nga të gjithë ligjet është Ligji për Rregullatoren e Energjisë. Ky ligj do të mundësojë krijimin e një organi të pavarur rregullues që do të jetë përgjegjës për liçensimin e prodhuesve dhe të furnizuesve të energjisë në Kosovë, bazuar në parime objektive, transparente dhe jo-diskriminuese. Zyra e Rregullatorit për Energji do të jetë përgjegjëse për rregullimin dhe miratimin e tarifave dhe metodologjisë tarifore për konsumatorët në amvisëri, gjë që do të mundësojë furnizimin e sigurtë me energji me një çmim të arsyeshëm.

Dy ligje e tjera janë pjesë e një pakoje që përfshin Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike. Ligji për Energji merret me vendosjen e parimeve themelore dhe me rolin e palëve të ndryshme në krijimin e strategjisë për energjinë dhe programeve të energjisë për Kosovën. Njëherësh, në këtë ligj janë përfshirë edhe politikë që do të sigurojnë përdorimin efikas të energjisë dhe përdorimin e burimeve rigjeneruese.

Ligji për Energjinë Elektrike themelon rregullat dhe kushtet për prodhimin, bartjen, distribucionin, furnizimin dhe tregun e energjisë elektrike si dhe kushtet për tregun e energjisë elektrike. Në përgjithësi, këto dy ligje do të sigurojnë një funksionim më të mirë të sektorit të energjisë, duke mundësuar një furnizimin të sigurtë, të qëndrueshëm dhe më kualitativ me energji për të gjithë. Prandaj, ne shpresojmë se edhe institucionet tjera do të na bashkangjiten në planet dhe përpjekjet tona. Ne e kemi të qartë se ky është një proces që mund të marrë pak kohë. Megjithatë, me zbatimin transparent të ligjeve të sipërpërmendura, ne mendojmë se problemet në sektorin e energjisë, do të zgjidhen një herë e përgjithmonë.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjyhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikant Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Pamje nga salla e renovuar e Kuvendit

Fotografitë e Buletinit:

Harvard-University: p. 1, 2 ; OSCE: p. 3, 4, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 20, 21, 24; UNMIK-DPI: p. 6, 9; FNST.: p. 15; UNDP: p. 18.



ASI Newsletter

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.de-vrieze@omik.org
http://www.osce.org/kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t